Plani i Angazhimit të Palëve të Interesit

Solar4Kosovo II /
Ngrohtorja Solare e Qytetit Kosovë

Versioni 9 - 12 dhjetor 2022

Lëshuar nga:

ces CLEAN ENERGY SOLUTIONS	CES clean energy solutions GesmbH Schonbrunner Str. 297, 1120 Wien, Austria www.ic-ces.at

Përmbajtja

Lista e Tabelave 3
Lista e Figurave 3
Akronime dhe shkurtesa 4
Fjalorth dhe përkufizime 4
1 Objektivat dhe fushëveprimi i Planit për Angazhim të Palëve të Interesit 7
2 Projekti 8
2.1. Pasqyrë e shkurtër e Projektit 8
2.2. Koha 8
2.3. Relevanca e projektit për kornizën kombëtare të politikës së energjisë 8
2.4. Elementet teknike 9
2.5. Lokacioni, situata dhe konteksti i projektit 9
3 Kërkesat rregullatore për angazhimin e palëve të interesit 14
3.1. Korniza Ligjore Kombëtare e Kosovës për Angazhimin e Palëve të Interesit 15
3.2. Standardet ndërkombëtare për angazhimin e palëve të interesit të zbatueshme për projektin 16
3.3. Respektimi ligjor kombëtar me standardet përkatëse ndërkombëtare për angazhimin e palëve të interesit 19
4 Plani për Angazhim të Palëve të Interesit 20
4.1. Identifikimi i palëve të interesit 20
5 Programi për Angazhim të Palëve të Interesit 27
5.1. Strategjia e komunikimit për drejtimin e angazhimit të palëve të interesit sipas palëve kyçe të interesit 27
5.1.1. Strategjia e komunikimit gjatë Fazës Ndërtimore 34
5.2. Detyrat specifike në kuadër të përgatitjes së VNMS-së 38
5.3. Angazhimi i mëparshëm i palëve të interesit dhe aktivitetet e konsultimit 38
5.4. Aktivitete të tjera të PAPI-t në vazhdim dhe të planifikuara gjatë periudhës së VNMS-së në vitin 2022 40
5.4.1. Aktivitetet të përfunduara për informim të publikut 44
5.4.2. Raporti ESIA 44
5.4.3. Studimi Bazë për Ndikimin Social - SBNS 45
6 Burimet dhe përgjegjësitë për zbatimin e aktiviteteve për angazhimi të palëve të interesit 49
6.1. Përgjegjësitë e TERMOKOS-it 49
6.2. Palët e tjera përgjegjëse për zbatimin e PAPI-t 50

7 Mekanizmi për Ankesa 51
8 Monitorimi dhe Raportimi 54
9 Detajet e kontaktit dhe përgjegjësitë për zbatimin 54
10 Aneks 55
10.1. Shtojca 1: Formulari për Ankesa i Projektit 55
10.2. Shtojca 2: Procedura për Ankesa e Projektit 56
10.3. Shtojca 3: Regjistri për Ankesa i Projektit 57
10.4. Shtojca 4: Raport për Dokumentimin e Aktivitetit për Angazhim të Palëve të Interesit 58
10.5. Shtojca 5: Lista fillestare dhe informatat e kontaktit të OJQ-ve palë të interesit të identifikuara 59
10.6. Takimet e konsultimit për VNMS/PAPI, 21-22 korrik 2022 62
10.7. Letër informative e datës 19 gusht 2022 drejtuar Sekretariatit të KMZ-së për ZVM Gazimestan 93
Gazimestani (dhe Tyrbja e Bajraktarit) Kufijtë specifikë të zonës mbrojtëse. 97

Lista e Tabelave

Tabela 1 - Ligjet ndërkombëtare për angazhimin e palëve të interesit të zbatueshme për projektin 17
Tabela 2 - Analiza e hendekëve 19
Tabela 3 - Palët e interesit gjatë përgatitjes së projektit dhe VNMS-së 23
Tabela 4 - Planet dhe strategjitë për angazhim të palëve të interesit 26
Tabela 5- Aktivitetet për angazhim të palëve të interesit gjatë fazës ndërtimore 32
Tabela 6 - Aktivitetet për angazhim të palëve të interesit gjatë fazës së funksionimit 33
Tabela 7 - Aktivitetet e angazhimit të palëve të interesit gjatë fazës së VNMS-së (nëntor 2021- maj 2022)36
Tabela 8 - Angazhimi i palëve të interesit - Pasqyrë e aktiviteteve në vazhdim dhe të planifikuara 38
Tabela 9 - Shtresat e llojeve të përfituesve të intervistuar për studimin bazë 46

Lista e Figurave

Figura 1 - Harta e përgjithshme e impiantit solar 10
Figura 2 - Harta e lokacionit të projektit (statusi më 26 gusht 2022) 11
Figura 3 - Harta fillestare e palëve të interesit (Statusi 8 gusht 2022)..... 22
Figura 4 - Matrica e palëve të interesit sipas fuqisë dhe interesit të tyre për projektin e përgjithshëm Solar4KosovoII 25
Figura 5 - Kopja e njoftimit për fillimin e SBNS-së në gjuhën angleze (ana e pasme, ana e përparme) 45
Figura 6 - Formulari i kontaktit të drejtpërdrejtë për pyetje në ueb faqen e TERMOKOS-it 49

Akronime dhe shkurtesa

NQ	Ngrohtorja e Qytetit
BERZH	Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim
VNMS	Vlerësimi i Ndikimit Mjedisor dhe Social
SMS	Standardet Mjedisore dhe Sociale
BF	Bashkëpunimi Financiar
PMNI	Praktika e Mirë Ndërkombëtare e Industrisë
IFC	Korporata Financiare Ndërkombëtare
ILO	Organizata Ndërkombëtare e Punës
KfW	Kreditanstalt fur Wiederaufbau (Banka Gjermane për Zhvillim)
PRMJ	Plani për Rimëkëmbje të Mjeteve të Jetesës
MMPHI	Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
NEET	të rinj që nuk janë në punësim, arsim ose trajnim
OJQ	Organizatë Jo-Qeveritare
APP	Amvisëri të Prekura nga Projekti
PPP	Person i Prekur nga Projekti
NJZP	Njësia e Zbatimit të Projektit në TERMOKOS
RAE	Komuniteti Rom, Ashkali dhe Egjiptas
OZHQ	Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm
KAPI	Korniza për Angazhim të Palëve të Interesit
PAPI	Plani për Angazhim të Palëve të Interesit
SBNS	Studimi Bazë për Ndikimin Social

Fjalorth dhe përkufizime

Formular për komente - Formular përmes të cilit palët e interesit mund të paraqesin komente, pikëpamje dhe opinione me shkrim. Formularët për komente shpërndahen në takimet për konsultime publike.

Konsultim - Procesi për ndarje të informatave, ideve dhe shqetësimeve në një dialog të dyanshëm ndërmjet propozuesve të projektit dhe palëve të interesit, që ua lejon palëve të interesit t'i shprehin pikëpamjet e tyre dhe që këto të merren parasysh në vendimet për planifikimin dhe zbatimin e projektit.

Impiant me Kogjenerim (impianti NEK) - i njohur gjithashtu si nxehtësi dhe energji e kombinuar (NEK), gjenerim i shpërndarë ose energji e ricikluar - është prodhimi i njëkohshëm i dy ose më shumë formave të energjisë nga një burim i vetëm karburanti. Impiantet me kogjenerim shpesh operojnë shkallë të efiçiencës 50 deri në 70 për qind më të lartë sesa impiantet me një gjenerim të vetëm. Në termocentralin Kosova B në Obiliq ekziston një impiant NEK.

Shpalosje - Procesi i publikimit dhe vënies në dispozicion të informacionit në mënyra të ndryshme (si në internet / rrjete sociale, në kopje fizike ose në njoftime për shtyp).

Angazhim - Term i përgjithshëm për aktivitetin që e përfshirë si shpalosjen ashtu edhe konsultimin.

Ankesë - Ankesa formale nga individë, grupe, biznese dhe organizata që mendojnë se janë ndikuar ose mund të ndikohen negativisht nga aktivitetet e lidhura me projektin[1].

Procedura për Ankesa - Procesi i regjistrimit dhe adresimit të ankesave në mënyrë që ato të mund të përcillen deri në zgjidhje.

Palë të tjera të interesuara - Termi u referohet individëve, grupeve ose organizatave me interes në projekt, që mund të lindë për shkak të lokacionit të projektit, karakteristikave të tij, ndikimeve të tij, ose çështjeve që lidhen me interesin publik. Për shembull, këto palë mund të përfshijnë rregullatorë, zyrtarë qeveritarë, sektorin privat, komunitetin shkencor, akademikët, sindikatat, organizatat e grave, organizata të tjera të shoqërisë civile dhe grupe kulturore.

Palë të Prekura nga Projekti (PPP) - Termi përfshin ata që ka gjasa të preken nga projekti për shkak të ndikimeve aktuale ose risqeve potenciale ndaj mjedisit të tyre fizik, shëndetit, sigurisë, praktikave kulturore, mirëqenies ose mjeteve të jetesës. Këto palë të interesit mund të përfshijnë individë ose grupe, duke përfshirë komunitetet lokale.

Palë të interesit- janë persona ose grupe që preken drejtpërdrejt ose tërthorazi nga një projekt, si dhe ata që mund të kenë interesa në një projekt dhe/ose aftësi për të ndikuar në rezultatin e tij, pozitivisht ose negativisht. Palët e interesit mund të përfshijnë komunitetet ose individët e prekur në nivel lokal dhe përfaqësuesit e tyre formalë dhe informalë, autoritetet e qeverisjes kombëtare ose lokale, politikanë, udhëheqës fetarë, organizata të shoqërisë civile dhe grupe me interesa të veçanta, komunitetin akademik ose biznese të tjera.[2]

Palë e interesit[3] u referohet individëve ose grupeve/institucioneve të cilët:

a) preken ose ka gjasa të preken nga projekti (palë të prekura nga projekti); dhe
b) mund të kenë një interes për projektin (palë të tjera të interesuara).

Angazhim i palëve të interesuara[4] **-** është procesi i vazhdueshëm dhe përsëritës me të cilin Huamarrësi identifikon, komunikon dhe lehtëson një dialog të dyanshëm me personat e prekur nga vendimet dhe aktivitetet e tij, si dhe me të tjerët me interes në zbatimin dhe rezultatet e vendimeve të tij dhe të projektit. Këtu konsiderohen nevojat e ndryshme për qasje dhe komunikim të grupeve dhe individëve të ndryshëm, veçanërisht atyre më të pafavorizuar ose të cenueshëm, duke përfshirë marrjen në konsideratë të sfidave të komunikimit dhe qasjes fizike. Angazhimi fillon sa më shpejt që të jetë e mundur në përgatitjen e projektit, sepse identifikimi i hershëm dhe konsultimi me palët e prekura dhe të interesuara lejon që pikëpamjet dhe shqetësimet e palëve të interesuara të merren parasysh në dizajnin, zbatimin dhe funksionimin e projektit. Andaj, Angazhimi i Palëve të Interesit është gjithashtu aspekti kyç i procesit të zhvillimit të VNMS-së. Angazhimi transparent ndërmjet NJZP-së dhe palëve të interesit të projektit është element thelbësor i praktikës së mirë ndërkombëtare dhe në të njëjtën kohë mund të përmirësojë qëndrueshmërinë mjedisore

[1] https://www.kfw-entwicklungsbank.de/International-financing/KfW-Development-Bank/Service/Complaints/
[2] https://www.ifc.org/wps/wcm/connect/7048ede4-4155-4453-adb7-1c3cbe55df49/PartOne.pdf?MOD=AJPERES&CVID=jqeEYC2
[3] ESS10- GN4.3
[4] ESS10- GN4.1.

dhe sociale të projektit, të rrisë pranimin e projektit, si dhe të japë kontribut të rëndësishëm në hartimin dhe zbatimin e suksesshëm të projektit në të ardhmen.

Plani për Angazhim të Palëve të Interesit (PAPI) është dokument planifikimi që përshkruan kohën dhe metodat e angazhimit me palët e interesit gjatë gjithë ciklit jetësor të projektit, siç është dakorduar mes Bankës dhe Huamarrësit, duke bërë dallimin mes palëve të prekura nga projekti dhe palëve të tjera të interesuara. PAPI përshkruan edhe gamën dhe kohën e informacionit që duhet t'u komunikohet palëve të prekura nga projekti dhe palëve të tjera të interesuara, si dhe llojin e informacionit që duhet kërkuar prej tyre.

1 Objektivat dhe fushëveprimi i Planit për Angazhim të Palëve të Interesit

Ky Plan për Angazhim të Palëve të Interesit (PAPI) është përgatitur nga TERMOKOS (me mbështetjen e konsulentëve mjedisorë dhe socialë të CES-it) si pronar i projektit dhe pranues i financimit përmes huave dhe granteve nga Qeveria Gjermane të siguruara përmes KfW-së, si dhe bashkë-financimit nga BERZH-i.

Ky dokument është pjesë e paketës për shpalosje së bashku me dokumentin për VNMS-në (Vlerësimi i Ndikimit Mjedisor dhe Social) dhe studime të tjera sociale që do të përgatiten si pjesë e procesit. Ky PAPI përshkruan qasjen e TERMOKOS-it në angazhimin me palët e interesit, nga procesi i VNMS-së deri në të gjitha fazat e ciklit të projektit.
TERMOKOS-i gjithashtu do të mbështetet nga Komuna e Prishtinës dhe Komuna e Obiliqit në mënyrë që programin për angazhim të palëve të interesit t'ua komunikojë qartë të gjitha palëve të interesuara.

Ky PAPI do të përditësohet nga TERMOKOS-i në baza të rregullta për të pasqyruar progresin e Projektit, në veçanti kalendarin e planifikuar të punimeve. PAPI do të shpaloset për publikun në gjuhët shqipe, angleze dhe serbe, në ueb faqet e mëposhtme

- Ueb faqja e TERMOKOS e dedikuar për Solar4Kosovo https://TERMOKOS.org/category/solar-4-kosovo/
- Ueb faqja e Komunës së Prishtinës (https://prishtinaonline.com/), dhe Platforma Digjitale e Komunës për Konsultime Publike (https://platformadigjitale.com/Prishtina/)
- Ueb faqja e Komunës së Obiliqit (https://kk.rks-gov.net/obiliq/)

dhe i disponueshëm në kopje fizike në ambientet e TERMOKOS *(N.P. TERMOKOS Sh.A., Rr. 28 Nëntori nr.181, Prishtinë)*

Objektivi i këtij PAPI është të përmirësohet dhe lehtësohet vendimmarrja në lidhje me projektin dhe të krijohen mundësi për përfshirjen aktive të të gjitha palëve të interesit në kohën e duhur dhe në mënyrë kuptimplotë, dhe të ofrohen mundësi për të gjitha palët e interesit që të shprehin mendimet dhe shqetësimet e tyre që mund të ndikojnë në vendimet e projektit. Ky dokument përbën zbatimin e planifikuar të aktiviteteve për angazhim të palëve të interesit për të informuar procesin e VNMS-së dhe rezultatet e shpalosjes për projektin Solar4Kosovo II, në kohën e përgatitjes së VNMS-së.

Objektivat konkrete të dokumentit përfshijnë:

- Identifikimi i palët kryesore të interesit dhe ndërtimi dhe mbajtja një marrëdhënie konstruktive me ta, veçanërisht me personat e prekur nga projekti.
- Krijimi dhe sigurimi i mjeteve efektive për angazhimin adekuat me personat e prekur nga projekti për çështje që mund t'i prekin ata, në mënyrë që shqetësimet e tyre të adresohen në kohën e duhur
- Sigurimi që të gjithë palët e interesit të kenë mënyra për qasje në informacionin e projektit dhe informacionin mjedisor dhe social dhe mundësinë për të ngritur pyetjet dhe shqetësimet e tyre.

- Sigurimi që palët e interesit dhe personat e prekur nga projekti të jenë të informuar se TERMOKOS-i ka një sistem për t'iu përgjigjur dhe menaxhuar çdo çështje dhe ankesë të ngritur gjatë aktiviteteve të projektit, si dhe për t'i informuar ata për mjetet dhe mënyrat që duhet të përdoren në raste të tilla të ngritjes së çështjeve dhe ankesave.

2 Projekti

2.1. Pasqyrë e shkurtër e Projektit

Solar4Kosovo II / Ngrohtorja Solare e Prishtinës është projekt i TERMOKOS Sh.A. (kompania komunale e ngrohtores së Prishtinës) në Prishtinë, Kosovë, për ofrimin e kapaciteteve shtesë të energjisë termike për rrjetin e ngrohtores së Prishtinës të prodhuar në bazë termike-solare. Projekti synon furnizimin e amvisërive, institucioneve dhe bizneseve shtesë për t'u kyçur në rrjetin e ngrohtores së qytetit të TERMOKOS-it, me synimin e përgjithshëm për të krijuar një furnizim më ekonomik dhe më të besueshëm të ngrohjes në Prishtinë. Investimi i përgjithshëm do t'i mundësojë TERMOKOS-it ta furnizojë qytetin e Prishtinës me të paktën 65 GWh/a energji termike shtesë.

(Për detajet teknike të objektit solar-termik, ju lutemi shihni paragrafin 2.4) Projekti do të financohet nëpërmjet kredive dhe granteve nga Qeveria Gjermane të dhëna nëpërmjet KfW, si dhe me bashkëfinancim nga BERZH dhe një kontribut vetanak nga AEP-ja. AEP-ja mbështetet në çështjet administrative dhe politike nga Komuna e Prishtinës.

2.2. Koha

Faza e fizibilitetit është duke vazhduar ndërsa një fazë e projektimit dhe planifikimit do të fillojë në vitin 2023, e ndjekur nga faza e tenderimit dhe e ndërtimit, ndërsa vënia në punë mund të bëhet në mesin e vitit 2026[5]. Periudha primare e funksionimit të objektit llogaritet nga 25 deri në 30 vjet.

2.3. Relevanca e projektit për kornizën kombëtare të politikës së energjisë

Këto kapacitete të krijuara të energjisë së ripërtërishme përmenden edhe në kuadër të Strategjisë Kombëtare për Zhvillim 2016-2021 të miratuar nga Qeveria e Kosovës në janar 2016, e cila përfshin katër masa prioritare për zhvillimin e sektorit të energjisë, ndër të cilat është edhe plani i ndërtimit të kapaciteteve të reja dhe të qëndrueshme të prodhimit të energjisë elektrike.

Më tej, në Strategjinë Energjetike së Republikës së Kosovës 2017-2026 është përcaktuar objektivi strategjik për përmirësimin e kapaciteteve ekzistuese të sistemit termik dhe ndërtimin e kapaciteteve të reja. Qeveria planifikon të zbatojë zgjerimin e rrjetit të TERMOKOS-it në përputhje me masterplanin ekzistues për zgjerim, që përfshin edhe planin e ardhshëm për ndërtim të objekteve të energjisë solare.

Fillimi i zbatimit të masave të Energjisë Solare do të japë një mesazh të fortë si për qytetarët ashtu edhe për

[5] Sipas Raportit Përfundimtar, Studimi i Fizibilitetit: NQ Solare e madhe e Prishtinës, gusht 2022

IFN-të se TERMOKOS është i gatshëm të bëjë ndryshimin e karburantit me shembullin e tij dhe të inkurajojë iniciativat e tjera të energjisë së qëndrueshme në Kosovë dhe në rajonin e Ballkanit Perëndimor që të veprojnë në mënyrë të ngjashme.

2.4. Elementet teknike

Investimi parashikohet të përfshijë ndërtimin e kolektorëve solarë me një sipërfaqe të përafërt prej 70.000 m^2 dhe një gropë deponimi me kapacitet rreth 400.000 m^3 lëngje.

Për më tepër, pompa me absorbim të nxehtësisë (PAH) me një komponent ndihmës ngrohje do ta rrisë efiçiencën e përgjithshme të sistemit.

Objekti do të lidhet përmes tubacioneve nëntokësore (a) me tubacionin ekzistues të transmetimit të nxehtësisë nga Kosova B dhe (b) me rrjetin ekzistues të ngrohtores së qytetit të Prishtinës.

(a) Tubacioni ekzistues i transmisionit ndërmjet Termocentralit Kosova B në Obiliq dhe rrjetit të NQ të Prishtinës do të lidhet përmes një degëzimi të tubacionit lidhës "NEK" me gjatësi përafërsisht 1.6 km.

(b) Do të ketë gjithashtu një tubacion të drejtpërdrejtë nga Impianti Solar deri në qytetin e Prishtinës me gjatësi përafërsisht 4.2 km.

Të dy gjurmët e tubacionit përbëhen nga dy tuba paralelë secili që janë të groposura në përafërsisht 3 metra thellësi nën tokë. Një diametër i zakonshëm për tub mund të jetë DN400.

2.5. Lokacioni, situata dhe konteksti i projektit

Investimi përfshin ndërtimin e një objekti termik solar që ndodhet në një parcelë të pandërtuar afër Shkabajt (Komuna e Obiliqit) prej përafërsisht 25 ha.
Parcela gjithashtu kufizohet drejtpërdrejt me zonën e banimit Hade e Re me shtëpi të vetme familjare në zhvillim që lidhen me një projekt për zhvendosje të mbështetur nga Banka Botërore[6] për zgjerimin e mihjes së hapur të thëngjillit afër fshatit Hade (Komuna e Obiliqit). Për më tepër, parcela aktualisht përdoret për aktivitete bujqësore (prodhimi i drithit), dhe 6 varre janë vendosur që nga viti 2018 në një parcelë të vogël toke të caktuar për këtë sipas planit rregullues urbanistik të Hades së Re.

Një korridor prej tre linjash të tensionit të lartë e përshkon parcelën nga jugperëndimi në verilindje, duke ndarë fushën e kolektorit nga zona e banimit. Përgjatë këtij korridori të tensionit të lartë, po ashtu është planifikuar një gjurmë e një seksioni 2x1 korsi të unazës së brendshme të Prishtinës nga një projekt i BERZH-

[6] Kosova - Projekti për Asistencë Teknike për Energji nga Thëngjilli: plani i zhvendosjes (Vëllimi 2): Korniza e politikës për zhvendosjet për blerjen e tokës për zonën e re të fushës së mihjes (anglisht). Uashington, D.C.: Grupi i Bankës Botërore
http://documents.worldbank.org/curated/en/148241468088161508/Resettlement-policy-framework-for-land-acquisition-for-the-new-mining-field-zone

it[7].

Në afërsi në veriperëndim, jashtë gjurmës së projektit, monumenti i Gazimestanit i kishës serbo-ortodokse shtrihet me zonën e tij të mbrojtur kulturore. Kjo zonë përkon pjesërisht me Rezervatin Natyror të Gazimestanit, i cili është gjithashtu fqinj me monumentin fetar të zonës së Tyrbes së Bajraktarit në afërsi në verilindje të gjurmës. Statusi i Rezervatit Natyror të Gazimestanit është në proces rishikimi nga administrata publike, për shkak të mungesës së specieve të mbrojtura përkatësisht mungesës totale të vlerave unike.

Tubacionet nëntokësore të përmendura më lart do të ndërtohen (të paktën pjesërisht) në tokë private dhe bujqësore, si dhe përgjatë rrugëve publike dhe vendkalimeve nëpër lagjen periferike të Arbërisë/Dragodan deri në stadiumin sportiv 'Fadil Vokrri' afër monumentit Newborn në Prishtinë, ku tubacioni do të futet në arterien kryesore ekzistuese të NQ-së.

Zgjerimet e rrjetit të ngrohtores së qytetit me shumë mundësi do të bëhen në lagjet Tophane dhe Arbëri Veri, sipas një Masterplani për zgjerimet e ardhshme, por ende nuk është marrë një vendim.

Figura 1 Pamja ajrore e pjesës perëndimore të Prishtinës tregon gjurmën e projektit të objektit Solar-Termik (kolektorët në të kaltër, deponija në të hirtë, shpatet në të bardhë), rrugët në formë rrjeti të vendbanimit të Hades së Re në zhvillim dhe shtrirjet e përkohshme të dy gjurmëve të tubacionit.
Figura 2 Harta Sipas studimit teknik të fizibilitetit të korrikut 2022, gjurma e zonës së projektit (vija vjollcë në Figurën 1) është parashikuar në zonat e fundit bujqësore midis zonës së Tyrbes së Bajraktarit dhe zonës së re të banimit Hade e Re. Në lagjen veriore të zonës së projektit Solar4Kosovo shtrihet zona e Monumentit të Gazimestanit dhe Tyrbja e Bajraktarit, i cili nuk ndikohet drejtpërdrejt nga gjurmët e projektit. Lokacionet e varreve janë paraqitur si varre ekzistuese në Figurën 2.

[7] Unaza e brendshme e Prishtinës, BERZH - https://www.ebrd.com/work-with-us/projects/psd/50938.html

Figura 1 - Harta e përgjithshme e impiantit solar



Figura 2 - Harta e lokacionit të projektit (statusi më 26 gusht 2022)


MAZGIT
Gazimestan Monument
OBILIQ
Bajraktari Tomb
Planned ringroad
Hade e Re
School
Iliria Str.
Bataljoni Atlantiku Str.
PRISHTINE
Iber Lepenc
0 50 100 150 Meters
Project Site Boundary
Existing Agricultural land
Existing graveyard
Planned graveyard according to URP "Hade e Re"
Planned Heat Storage
Planned Collector Field
Planned Operation Building
Planned ringroad
Settlement planned boundary URP "Hade e Re"
Boundary of Gazimestan from SPZ 03/L-039 Annex-Maps, Index No.29
Gazimestan Natural Reserve supposed boundary
Bajraktari tomb site
Bajraktari tomb site buffer zone 50m
Parcels
Electric pole
High Voltage electric lines
TP Pipe CHP DN400
DH supply NORTH3 DN500
Iber Lepenc canal
Highway
National road
Municipal boundary
30th August 2022
ESIA SDH Pristina
LAND USE MAP OF PROJECT SITE
Scale 1:5,300

3 Kërkesat rregullatore për angazhimin e palëve të interesit

Për të siguruar që të minimizohen risqet dhe ndikimet potencialisht negative mjedisore dhe sociale që rrjedhin nga aktivitetet e projektit, dhe për t'u përpjekur për të rritur përfitimet për komunitetet lokale në zonën e projektit, projekti do të kryhet në përputhje me standardet dhe udhëzimet përkatëse të mëposhtme.

- Ligjet dhe rregulloret e Republikës së Kosovës;

- Ligjet ndërkombëtare duke përfshirë konventat dhe traktatet e miratuara nga Republika e Kosovës dhe zbatueshmëria e tyre për Projektin;

- Udhëzimet për Qëndrueshmëri nga Banka për Zhvillim KfW[8]:
  - Standardet Mjedisore dhe Sociale të Bankës Botërore (SMS 1-6, 8, 10 për VNMS/PVMS, SMS 5 për PRMJ)[9];
  - Udhëzimet e Përgjithshme për Mjedis, Shëndet dhe Siguri (MSHS) të Grupit të Bankës Botërore,
    - Udhëzimet për MSHS për Transmisionin dhe Shpërndarjen e Energjisë Elektrike dhe çdo Udhëzues tjetër për MSHS specifik për sektorin që zbatohet për projektin, si p.sh. për Sistemet e Shpërndarjes së Gazit dhe/ose Energjisë Termike;
  - Udhëzime për përfshirjen e standardeve dhe parimeve të të drejtave të njeriut, duke përfshirë gjininë, në propozimet e programit për bashkëpunimin dypalësh teknik dhe financiar gjerman[10];
  - Konventat themelore të Organizatës Ndërkombëtare të Punës (ILO);
  - Kornizat e Bashkimit Evropian (BE) për Politikat për Mjedisin[11] dhe Politikës Sociale dhe për Punësim.[12]
  - Për çështjet e të drejtave mbi tokën, Udhëzimet Vullnetare për Qeverisjen me Përgjegjësi të Zotërimit të Tokës, Peshkimit dhe Pyjeve (VGGT)[13] ;

Detaje të mëtejshme për këto standarde, të zbatueshme për këtë projekt janë pasqyruar në draft dokumentin e VNMS-së.

[8] https://www.kfw-entwicklungsbank.de/PDF/Download-Center/PDF-Dokumente-Richtlinien/Nachhaltigkeitsrichtlinie_EN.pdf
[9] http://www.worldbank.org/en/projects-operations/environmental-and-social-framework/brief/environmental-andsocial-standards
[10] http://www.bmz.de/en/zentrales_downloadarchiv/themen_und_schwerpunkte/menschenrechte/Leitfaden_PV_2013_en.pdf
11 https://www.europarl.europa.eu/factsheets/en/section/191/social-and-employment-policy
[12] https://www.europarl.europa.eu/factsheets/en/section/191/social-and-employment-policy
[13] http://www.fao.org/docrep/016/i2801e/i2801e.pdf

3.1. Korniza Ligjore Kombëtare e Kosovës për Angazhimin e Palëve të Interesit

Ligjet dhe udhëzimet administrative të mëposhtme përcaktojnë kërkesat kombëtare për veprimet e shpalosjes, komunikimit dhe konsultimit publik.

- Kushtetuta e **Republikës së Kosovës** ua garanton qytetarëve të Kosovës të drejtën për t'u përfshirë në vendimmarrje për çështjet që kanë të bëjnë me mjedisin ku jetojnë.
  - Neni 41 i kësaj Kushtetute i jep të drejtën qytetarit për qasje në dokumentacionin publik, me përjashtim të atyre që kufizohen me ligj, për shkak të privatësisë, sekretit afarist apo informacionit të klasifikuar të sigurisë.
  - Neni 68 për informimin dhe konsultimin e publikut specifikon se përveç takimeve të detyrueshme publike dy herë në vit, komunat janë të detyruara t'i informojnë qytetarët për çdo plan apo program të rëndësishëm publik, siç rregullohet me statutin e komunës.
  - Përveç kësaj, sipas nenit 69, çdo person apo organizatë me interes në komunë ka të drejtë të paraqesë peticion në kuvendin komunal për çdo çështje që lidhet me përgjegjësitë dhe kompetencat e komunës. o Bazuar në nenin 124 të Kushtetutës, komunave u është dhënë një shkallë e lartë e vetëqeverisjes lokale që të inkurajojnë dhe sigurojnë pjesëmarrje aktive të të gjithë qytetarëve në procesin e vendimmarrjes së organeve komunale.

- **Ligji Nr. 03/L-215 për Qasjen në Dokumente Publike** garanton të drejtën e çdo personi fizik dhe juridik për të pasur qasje, pa diskriminim në asnjë bazë, pas aplikimit paraprak, në dokumentet zyrtare të mbajtura, hartuara ose pranuara nga institucionet publike. Arsyet për qasje të kufizuar janë përkthyer nga neni 4 i Kushtetutës.

- **Ligji Nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale** përcakton të drejtat, përgjegjësitë, parimet dhe masat ndëshkuese që kanë të bëjnë me mbrojtjen e të dhënave personale dhe privatësisë së individit. Ky ligj përcakton përgjegjësitë e institucionit përgjegjës për mbikëqyrjen e legjitimitetit të përpunimit të të dhënave dhe qasjes në dokumentet publike.

- **Kosovë: Ligji Nr. 02/L-37 për përdorimin e gjuhëve** - Rregullon përdorimin e gjuhëve zyrtare, si dhe të gjuhëve të komuniteteve, gjuha amtare e të cilave nuk është gjuhë zyrtare në institucionet e Kosovës dhe organizatat dhe ndërmarrjet e tjera publike. I jep status të barabartë shqipes dhe serbishtes si gjuhë zyrtare të Kosovës. Ofron të drejtën e të gjitha komuniteteve në Kosovë për ta mbrojtur, ruajtur dhe promovuar identitetin e tyre gjuhësor.

Lidhur me Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis kërkohen aktivitetet e mëposhtme të angazhimit:

- **Ligji Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit** parasheh detyrimin e institucioneve qendrore dhe lokale dhe të gjitha organizatave tjera të autorizuara që rregullisht, në kohë dhe objektivisht, të informojnë publikun për gjendjen mjedisore, cilësinë e mjedisit dhe emetimet, masat paralajmëruese dhe ndotjen që mund të përbëjë kërcënim për jetën dhe shëndetin e njeriut. Gjithashtu siguron pjesëmarrjen e publikut në proceset vendimmarrëse.

- **Ligji Nr. 03/L-214 për Vlerësimin e Ndikimit Mjedisor** - rregullon procedurën e Vlerësimit të Ndikimit Mjedisor (VNM), duke përfshirë obligimin e autoriteteve për të mbajtur dëgjesa publike për projektet që kërkojnë VNM. Ligji për VNM kërkon që Raporti i Vlerësimit të Ndikimit Mjedisor t'i nënshtrohet debatit

publik dhe se rezultatet e këtyre konsultimeve duhet të merren parasysh në marrjen e vendimit për pëlqimin mjedisor.

- Për sa i përket organizimit të një **dëgjese publike** sipas nenit 20 të Ligjit Nr. 03/L-214 për VNM, Propozuesi i Projektit duhet t'i informojë palët e interesit për organizimin e një debati publik pasi të jetë marrë njoftimi për dëgjim publik nga MMPHI-ja. Ngjarja publike duhet të mbahet brenda njëzet (20) deri në tridhjetë (30) ditë pasi të jenë informuar aplikuesi, autoritetet mjedisore dhe publiku i interesuar.[14]
- **Ndryshimet në një studim të VNM-së -** Sipas nenit 21 të Ligjit Nr. 03/L-214 për VNM, MMPHI-ja brenda dhjetë (10) ditësh nga përfundimi i debatit publik do të shqyrtojë vërejtjet dhe mendimet e dala nga debati publik. Ministria mund t'i kërkojë aplikantit të ndryshojë ose plotësojë elementet e përcaktuara të raportit të paraqitur të VNM-së. Në rast mosrespektimi, MMPHI-ja ka të drejtë ta pezullojë procedurën e shqyrtimit.

- **Udhëzimi Administrativ i MMPH-së Nr. 16/2015 për informimin, pjesëmarrjen e publikut dhe palët e interesuara në procedurat e vlerësimit të ndikimit mjedisor**, përcakton metodat për njoftimin e publikut të interesuar dhe mundësimin e pjesëmarrjes së tyre gjatë gjithë procesit të VNM-së.
- Udhëzimi Administrativ i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL) nr. 06/2018 për standardet minimale të konsultimit publik në komuna, synon të promovojë dhe sigurojë pjesëmarrjen e qytetarëve dhe palëve të tjera të interesuara nga autoritetet lokale në nivel lokal të procesit për hartim të politikave dhe të vendimmarrjes për të promovuar transparencën komunale si dhe për zhvillimin e politikave të qëndrueshme të interesit të përgjithshëm.
- Udhëzimi Administrativ (MAPL) Nr. 04/2018 për transparencën në komuna synon të forcojë transparencën e organeve komunale për informimin, publikimin e akteve normative, vendimeve dhe dokumenteve të nxjerra nga organet komunale të cilat janë në interes të qytetarëve dhe palëve të tjera të interesit, si dhe rritjen e pjesëmarrjes në vendimmarrje.

3.2. Standardet ndërkombëtare për angazhimin e palëve të interesit të zbatueshme për projektin

Angazhimi i palëve të interesit rregullohet nga ligjet ndërkombëtare të mëposhtme, të cilat përshkruhen më tej në tabelën e mëposhtme *(Tabela 1):*

- Udhëzimet për Qëndrueshmëri nga Banka për Zhvillim KfW (shkurt 2022) - Seksioni 4.9 për Angazhimin e Palëve të Interesit dhe Menaxhimin e Ankesave në masat e BF-së[15].
- Korniza Mjedisore dhe Sociale (KMS) e Bankës Botërore[16] hyri në fuqi më 1 tetor 2018 dhe përfshin 10 Standarde Mjedisore dhe Sociale (SMS) që përbëjnë Udhëzimet për Mbrojtjen Mjedisore dhe Sociale.
- Kërkesat e Performancës (KP) të BERZH-it janë përcaktuar në Politikën Mjedisore dhe Sociale të BERZH-it 2019

[14] Shpalosja publike ose dëgjesa në lidhje me trashëgiminë kulturore nuk kërkohet me ligj, pasi që lokacioni i projektit nuk ndërhyn në kufijtë e zonë së veçantë të mbrojtur të Gazimestanit (dhe Tyrbes së Bajraktarit).

[15]

[16] www.worldbank.org/en/projects-operations/environmental-and-social-framework/brief/environmental-and-social-standards

Tabela 1 - Ligjet ndërkombëtare për angazhimin e palëve të interesit të zbatueshme për projektin

Tema	Udhëzimet për Qëndrueshmëri nga Banka për Zhvillim KfW	Korniza Mjedisore dhe Sociale (KMS) e Bankës Botërore	Kërkesat e Performancës (KP) nga BERZH-i
Angazhimi i palëve të interesit	4.9.1. Angazhimi i Palëve të Interesit, p.sh. në formën e dëgjesave publike, duhet të planifikohet për fazën e fushëveprimit të procesit të VNMS-së dhe për prezantimin e draft raportit të VNMS-së, në mënyrë që të kryhen konsultime me personat e prekur dhe/ose përfaqësuesit e tyre të komunitetit, palët e interesit, kooperativat ose organizatat joqeveritare (OJQ). Agjencia ekzekutuese kërkohet të kryejë një proces kuptimplotë pjesëmarrjeje dhe konsultimi që u mundëson personave të prekur dhe palëve të interesit t'i shprehin pikëpamjet dhe shqetësimet e tyre mbi risqet e projektit, ndikimet dhe masat e propozuara zbutëse. Në të njëjtën kohë, procesi do t'i mundësojë agjencisë ekzekutuese që t'i marrë parasysh këto pikëpamje dhe të reagojë. Për hir të transparencës, agjencisë ekzekutuese i kërkohet ta shpalosë informacionin përkatës dhe një përmbledhje jo teknike për vlerësimin mjedisor dhe social të masës për BF nëpërmjet kanaleve të duhura mediatike në një vend të qasshëm dhe në kohën e duhur, në mënyrë kulturalisht të përshtatshme.	Standardi Mjedisor dhe Social Nr. 10 (SMS 10) merret me Angazhimin e palëve të interesit dhe shpalosjen e informacionit. Dispozitat e këtij standardi duhet të lexohen në lidhje me SMS-të e tjera të zbatueshme. Kërkesat specifike janë theksuar më poshtë: • Huamarrësit do të fillojnë me angazhimin e palëve të interesit sa më shpejt që të jetë e mundur në procesin e zhvillimit të projektit dhe në një kornizë kohore që mundëson konsultime kuptimplota me palët e interesit për hartimin e projektit dhe do ta ruajnë këtë angazhim gjatë gjithë ciklit të projektit. Natyra, qëllimi dhe shpeshtësia e angazhimit të palëve të interesit do të jenë në proporcion me natyrën dhe shkallën e projektit dhe risqet dhe ndikimet e tij të mundshme. • Huamarrësit do të angazhohen në konsultime domethënëse me të gjitha palët e interesit. Huamarrësit do t'u ofrojnë palëve të interesit informacion në kohë, të përshtatshëm, të kuptueshëm dhe të qasshëm, dhe do të konsultohen me ta në një mënyrë të përshtatshme kulturalisht, e cila është pa manipulime, ndërhyrje, shtrëngime, diskriminime dhe frikësime.	KP 10 e BERZH-it[17]: Shpalosja e informacionit dhe angazhimi i palëve të interesit e pranon rëndësinë e një angazhimi të hapur dhe transparent mes klientit, punonjësve të tij, përfaqësuesve të punëtorëve, komuniteteve lokale dhe personave të prekur nga projekti dhe, kur është e përshtatshme, akterëve të tjerë të projektit, si një element thelbësor i praktikës së mirë ndërkombëtare dhe qeverisjes korporative. Angazhim i tillë është edhe mënyrë për të përmirësuar qëndrueshmërinë mjedisore, sociale dhe të përgjithshme të projekteve. Në veçanti, angazhimi efektiv i komunitetit, i përshtatshëm për natyrën dhe shkallën e projektit, promovon performancë të shëndoshë dhe të qëndrueshme mjedisore dhe sociale dhe mund të çojë në përmirësimin e rezultateve financiare, sociale dhe mjedisore, së bashku me përfitime të zgjeruara të komunitetit. Si përmbledhje, sistemi i mëposhtëm i angazhimit të palëve të interesit është i zbatueshëm për Projektin: • Angazhimi i palëve të interesit do të përfshijë elementët e mëposhtëm: identifikimin dhe analizën e palëve të interesit, planifikimin e angazhimit të palëve të interesit, shpalosjen e informacionit, konsultimin kuptimplotë, zbatimin e një mekanizmi për ankesa dhe raportimin e vazhdueshëm tek palët relevante të interesit.

[17] https://www.ebrd.com/news/publications/policies/environmental-and-social-policy-esp.html

Tema	Udhëzimet për Qëndrueshmëri nga Banka për Zhvillim KfW	Korniza Mjedisore dhe Sociale (KMS) e Bankës Botërore	Kërkesat e Performancës (KP) nga BERZH-i
	I gjithë procesi do të jetë gjithëpërfshirës dhe do të zbatohet në të gjitha fazat e masës për BF.	• Procesi i angazhimit të palëve të interesit do të përfshijë sa vijon: (i) identifikimin dhe analizën e palëve të interesit; (ii) planifikimin e mënyrave për t'u angazhuar; (iii) shpalosjen e informacionit; (iv) konsultimin me palët e interesit; (v) adresimin dhe përgjigjen ndaj ankesave; dhe (vi) raportimin tek palët e interesit. • Huamarrësi do të mbajë dhe do të shpalosë një regjistër të angazhimit të palëve të interesit si një regjistër i dokumentuar i angazhimit të palëve të interesit, duke përfshirë një përshkrim të palëve të interesit të konsultuara, një përmbledhje të reagimeve të marra dhe një shpjegim të shkurtër se si është marrë parasysh reagimi, ose arsyet pse nuk është marrë. • Sa më herët që të jetë e mundur në Projekt, përpara vlerësimit, Huamarrësi do të zhvillojë dhe shpalosë një Plan për Angazhim të Palëve të Interesit në përpjesëtim me natyrën dhe shkallën e aktivitetit dhe/ose investimit dhe risqet e tij të mundshme. PAPI është dokument i gjallë; ndryshimet e mundshme nxiten nga çdo ndryshim në Projekt gjatë zbatimit të tij.	• Klienti do të kryejë angazhimin e palëve të interesit duke iu ofruar palëve të interesit qasje në informacionin në kohë, relevant, të kuptueshëm dhe të qasshëm, në një mënyrë kuptimplote, efektive, gjithëpërfshirëse dhe të përshtatshme kulturalisht, dhe pa manipulime, ndërhyrje, shtrëngime, frikësime dhe hakmarrje. • Angazhimi i palëve të interesit do të fillojë sa më shpejt që të jetë e mundur në zhvillimin e projektit dhe do të vazhdojë gjatë gjithë ciklit jetësor të projektit. • Natyra dhe shpeshtësia e angazhimit të palëve të interesit në të gjitha fazat e zhvillimit të projektit do të jetë në përpjesëtim me natyrën dhe shkallën e projektit, risqet dhe ndikimet e mundshme negative mjedisore ose sociale, si dhe nivelin e interesit të palëve të interesit. • Klienti do të jetë në përputhje me kërkesat e zbatueshme të ligjit kombëtar në lidhje me informacionin dhe konsultimin publik, duke përfshirë ato ligje që zbatojnë detyrimet e vendit pritës sipas ligjit ndërkombëtar publik. • Klienti do të sigurojë që të shpaloset informacioni i duhur mjedisor dhe social dhe të zhvillohen konsultime domethënëse me palët e interesit të projektit

Tema	Udhëzimet për Qëndrueshmëri nga Banka për Zhvillim KfW	Korniza Mjedisore dhe Sociale (KMS) e Bankës Botërore	Kërkesat e Performancës (KP) nga BERZH-i
		Nëse projekti pëson ndryshime të rëndësishme, përditësime të tilla do të pasqyrohen në PAPI dhe dokumenti do të ri-shpaloset	dhe aty ku është e përshtatshme, merren parasysh komentet e dhëna përmes konsultimit; dhe • Klienti do të përcaktojë rolet, përgjegjësitë dhe autoritetin e qartë si dhe do të caktojë personel specifik për zbatimin dhe monitorimin e aktiviteteve të angazhimit të palëve të interesit.
Ankesat	4.9.2. Agjencia ekzekutuese duhet të krijojë një proces për ankesa për masën për BF për marrjen dhe trajtimin e shqetësimeve dhe ankesave të punonjësve dhe anëtarëve të publikut të prekur. Procedura duhet të jetë kulturalisht e përshtatshme dhe në përpjesëtim me masën për BF. Ankesat dhe përpunimi dhe zgjidhja e tyre duhet të dokumentohen dhe të jenë pjesë e raportimit tek Banka për Zhvillim KfW.	Sipas SMS 10, Huamarrësi duhet gjithashtu të propozojë dhe zbatojë një mekanizëm për ankesa për të marrë dhe lehtësuar në kohën e duhur zgjidhjen e shqetësimeve dhe ankesave të palëve të prekura nga projekti në lidhje me performancën mjedisore dhe sociale të projektit.	KP 10. Klienti do të sigurojë që ankesat nga palët e interesit të marrin përgjigje dhe të menaxhohen siç duhet.

3.3. Respektimi ligjor kombëtar me standardet përkatëse ndërkombëtare për angazhimin e palëve të interesit

Tabela e mëposhtme ilustron me një analizë të hendekëve se si ligjet e Kosovës u përmbahen standardeve relevante ndërkombëtare që zbatohen për këtë projekt për angazhimin e palëve të interesit.

Tabela 2 - Analiza e hendekëve

Tema	Hendekët	Masat e projektit
Angazhimi i palëve të interesit	Elaborimi i PAPI-t nuk është paraparë në asnjë ligj të Kosovës. Për më tepër, ekziston një hendek kohor për konsultime publike.	Përgatitja e PAPI-t dhe përditësimi i vazhdueshëm sipas standardeve të donatorëve.
Ankesat	Sipas ligjeve të Kosovës,	Krijimi i mekanizmave për ankesa dhe

	nuk ka asnjë kërkesë për të pasur mekanizëm për zgjidhjen e ankesave në të gjitha fazat e projektit.	procedurat e detajuara në këtë PAPI.

4 Plani për Angazhim të Palëve të Interesit

4.1. Identifikimi i palëve të interesit

Objektivi i identifikimit të palëve të interesit është të përcaktohet se cilat organizata dhe individë mund të preken drejtpërdrejt ose tërthorazi (pozitivisht dhe negativisht) ose të kenë interes në Projekt. Hapi i parë dhe i rëndësishëm në procesin e angazhimit të palëve të interesit është identifikimi i palëve të interesit, kush janë ata, grupimet dhe nëngrupet e tyre. Identifikimi i palëve të interesit do të jetë një proces i vazhdueshëm gjatë gjithë jetës së projektit, që kërkon monitorim, shqyrtim dhe përditësime të rregullta.

Megjithatë, brenda kornizës më të gjerë të aktiviteteve të projektit që do të ndërmerren, mund të identifikohen kategoritë e mëposhtme të palëve të interesit:

a) **Palët e prekura nga projekti** - ata që janë të prekur ose që ka gjasa të preken nga projekti

b) **Palët e tjera të interesuara** - ata që mund të kenë interes për projektin dhe komponentët e tij

c) **Palët e interesit përfituese të projektit**.

Palët e interesit fillestare të identifikuara (pa kategorizim) përfshijnë ndër të tjera:
(Këto janë të treguara në Figurën 3 më poshtë)

- Komuna e Prishtinës,
- Komuna e Obiliqit
- Përfaqësimi i Lagjeve Urbane Tophane & Arbëria (në Prishtinë)
- Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI)
- K ëshilli Monitorues i Zbatimit për Zonat e Veçanta të Mbrojtura, Kosovë (në lidhje me Zonën e Veçantë të Mbrojtur të Gazimestanit, anëtarë statutore të KMZ-së janë kisha ortodokse serbe, Delegacioni i BE-së, Qeveria e Kosovës)
- Përfaqësueset e komunitetit mysliman
- Pronarët e shtëpive, pronarët e varreve (në Hade të Re të Obiliqit)
- Pronarët e tokave, Fermerët Formalë, Fermerët Informalë (në Hade të Re të Obiliqit),
- Pronarët e shtëpive/qiramarrësit në zonat e reja të furnizimit nga ngrohtorja e Prishtinës
- Institucione dhe agjenci publike (AMMK, KTKP, etj.)
- Bizneset përgjatë rrugëve të tubacionit
- Menaxherët e Infrastrukturës (KOSTT, Kompania Ibër-Lepenc., Administrata Rrugore)
- OJQ

Grupet e mundshme të cenueshme të identifikuara përfshijnë në mesin e komuniteteve të tjera, fëmijët, të moshuarit, gratë, të papunët dhe pakicat etnike që banojnë në afërsi të projektit. Më shumë detaje janë dhënë në VNMS (seksioni 12.5. Baza socio-ekonomike) Lokacionet e vendbanimeve të komuniteteve që do të ndikohen nga projekti, drejtpërdrejt dhe tërthorazi, mbulojnë dy komuna (Obiliqin dhe Prishtinën), dhe tri vendbanime ngjitur që ndodhen brenda rrezes 1-2 km nga lokacioni i propozuar i projektit: fshatrat Hade e Re, Mazgit dhe Shkabaj. Nga tri vendbanimet, Hade e Re klasifikohet si zona e cila do të ndikohet drejtpërdrejt nga projekti, ndërsa dy fshatrat e tjerë ka gjasa të ndikohen nga projekti vetëm në mënyrë indirekte.

- Pakicat etnike – romë, egjiptas, ashkali (REA)
- Komuniteti ortodoks serb

Figura 3 – Harta fillestare e palëve të interesit (Statusi 8 gusht 2022)

Ngrohtorja solare e qytetit në Prishtinë – Elementet e projektit

Harta e palëve të interesit

Këshilli i KMZ-së për Monumentin e Gazimestanit dhe Zonën e Veçantë të Mbrojtur të Tyrbes së Bajraktarit

Pronarët e varreve

Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit

Kanali Ibër-Lepenc

Impianti Solar-Termal në Shkabaj
Tubacionet lidhëse
Ngrohtorja Qendrore në Prishtinë

Autoriteti Kombëtar Rrugor
Shkolla/Fëmijë
Pronarët e tokave
KOSTT
Fermerët, përdoruesit e tokave
Banorët në Prishtinë (Arbëri, Tophane)
Persona të cenueshëm
Qeveria/MMPHI
Komuna e Prishtinës
Banorët (e ardhëm) në Hade e Re
Komuna e Obiliqit
Klubet sportive
Subjektet afariste
OJQ
BERZH + Banka KfW

Identifikimi dhe kategorizimi fillestar i palëve të interesit për Projektin është bërë në disa mënyra, duke përfshirë:

- Duke u mbështetur në njohuritë lokale dhe ndërkombëtare të konsulentëve mjedisorë dhe socialë;
- Reagimet nga konsultimet e mbajtura me palët kryesore të interesit;
- Studimi; dhe
- Vëzhgimet e bëra gjatë vizitave në terren në zonat lokale në zonën e Projektit.

Tabela 3 më poshtë jep informacion përmbledhës në lidhje me tri kategoritë e gjera të palëve të interesit gjatë përgatitjes së VNMS-së dhe sipas hartës së projektit.

Tabela 3 - Palët e interesit gjatë përgatitjes së projektit dhe VNMS-së

Zona	***Grupet e palëve të interesit***	***Përshkrimi***
Komunat e Obiliqit dhe Prishtinës dhe zonat Shkabaj, Hade e Re, Mazgit, Arbëri/Dragodan, Tophane,	***Personat e Prekur nga Projekti (PPP-të)***	Popullata lokale nga komunat e prekura: Pronarët e tokave, përdoruesit e tokave dhe përdoruesit e burimeve natyrore Grupet e cenueshme - komunitetet RAE dhe pakicat tjera etnike, gratë, të rinjtë NEET, të tjerët që mund të identifikohen gjatë zbatimit të projektit Komunitetet rreth lokacionit të projektit dhe përgjatë gjurmës së tubacionit në Obiliq dhe Prishtinë në zonat në dhe përreth lokacionit të projektit (Hade e Re, Shkabaj; Mazgit) si dhe përgjatë vijës së tubacioneve lidhëse NEK si dhe tubacionit lidhës të NQ-së. Kush mund të ndikohet nga trafiku, zhurma ose ndikimi vizual. Niveli i ndikimit dhe masat zbutëse në secilën fazë të projektit përshkruhen në raportin e VNMS-së
Republika e Kosovës Rajoni i Prishtinës Komuna e Prishtinës Komuna e Obiliqit	***Palë të tjera të interesit të prekura nga projekti***	Institucionet dhe agjencitë publike në nivel qendror dhe lokal. Autoritetet që janë ose do të informohen dhe konsultohen si pjesë e procesit të VNMS-së. Angazhimi me departamente të ndryshme qeveritare përgjegjëse për tema të tilla si mjedisi, kultura, transporti, siguria, arkeologjia dhe burimet natyrore si proces në vazhdim gjatë gjithë VNM, VNMS Angazhimi për marrjen e informacionit dhe/ose dhënien e lejeve, pëlqimeve dhe opinioneve në përputhje me legjislacionin vendas, kontrolli i përputhshmërisë me legjislacionin vendas (si pjesë e fushëveprimit të VNMS-së) Komunitetet lokale mund të ndikohen nga ndikimet që lidhen me trafikun, zhurmën dhe ndryshimet mjedisore. Ata gjithashtu mund të jenë në gjendje të përfitojnë përmes punësimit dhe mundësive të biznesit. ***OJQ-të (përfshirë OJQ-të lokale, kombëtare dhe ndërkombëtare, si dhe***

Zona	*Grupet e palëve të interesit*	*Përshkrimi*
		mund të jenë të interesuar për një sërë çështjesh të ndryshme, duke filluar nga interesi për mbrojtjen e habitatit natyror të Gazimestanit, tek pasuritë kulturore/fetare, deri te ndikimet e mundshme në çështjet mjedisore. OJQ-të shpesh janë të interesuara të shqyrtojnë dhe komentojnë dokumentet e VNM-së dhe VNMS-së, veçanërisht në lidhje me identifikimin e ndikimeve mjedisore dhe sociale dhe mënyrave se si do të zbuten dhe menaxhohen këto ndikime. Media - Gazetarët dhe përfaqësuesit e tjerë të mediave shpesh janë të interesuar që të sigurojnë që popullatës t'i komunikohet informacion i qartë dhe transparent në lidhje me Projektin. Të interesuar për informacionin e përgjithshëm të projektit duke
Aglomeracioni i Prishtinës	*Palët e interesit përfituese të projektit* Këta janë individë ose grupe që do të përfitojnë drejtpërdrejt ose tërthorazi nga Projekti.	Këto përfitime përfshijnë qasje të drejtpërdrejtë në furnizimin nga ngrohtorja termike-solare (qoftë për përdorim banesor/komercial ose publik) në Prishtinë. Projektit mund t'i shtohet furnizim me ngrohje për klientët e mëtejshëm në afërsi të zonës së projektit. Edhe publiku i gjerë do të përfitojë nga projekti nëpërmjet përmirësimit të besueshmërisë së përgjithshme të furnizimit me ngrohje/energji kombëtare dhe nëpërmjet reduktimit të emetimeve të GS-ve dhe përmirësimit të tërthortë të cilësisë së ajrit. Palët e tjera të interesit përfituese të projektit përfshijnë TERMOKOS-in (kompania dhe punonjësit). Kjo mund të përfshijë vende të reja pune për funksionimin teknik, mirëmbajtjen e objektit si dhe administrimin e përgjithshëm të biznesit (për shkak të klientëve të rinj). Bizneset dhe kompanitë e përfshira në komponentët e projektit ose nënprojektit (fazat e planifikimit, dizajnit, ndërtimit, funksionimit). Komunat e Prishtinës dhe Obiliqit janë përfituese të tërthorta *Shih edhe përshkrimin në seksionin e Studimit Bazë për Ndikim Social 5.4.3.*

Figura 4 paraqet palët kryesore të interesit të identifikuara gjatë procesit të VNMS-së, sipas fuqisë dhe interesit të tyre për projektin e përgjithshëm Solar4Kosovo II.

Figura 4 - Matrica e palëve të interesit sipas fuqisë dhe interesit të tyre për projektin e përgjithshëm Solar4Kosovo II

Mesatare - E lartë	PËRFSHIRJE • OJQ mjedisore dhe për të drejtat e njeriut • Zyra e Rregullatorit të Energjisë • Korporata Energjetike e Kosovës • Kompani të Vlerësimit Mjedisor • Bizneset	ANGAZHIM DHE FUQIZIM • Termokos-i • Zyra e Kryeministrit • Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës • Pikat e fokusit komunale të Prishtinës dhe Obiliqit për projektin si dhe departamentet e komunikimit/marrëdhënieve publike • Këshillat Lokalë Komunalë. Udhëheqës të komunitetit ose subjekte të tjera që përfaqësojnë të interesuarit prej komuniteteve të prekura
Fuqia	INFORMIM Këshilli Monitorues i Zbatimit (KMZ) në lidhje me entitetet e pakicave, kulturore/fetare, si Kisha Ortodokse Serbe si mbrojtëse e Gazimestanit dhe Komuniteti Mysliman si pronar i Tyrbes së Bajraktarit. • Qendra Rajonale për Trashëgimi Kulturore-Prishtinë (QRTKP) • Publiku i gjerë i komunave të lokacioneve të projektit përkatës • Publiku i përgjithshëm në Kosovë • Akademikë / OJQ • Asociacioni i Komunave të Kosovës • Media lokale	KONSULTIMET Në Hade e Re, Mazgit dhe Shkabaj, Prishtinë - Tophane - Komunitetet e prekura më afër lokacioneve përkatëse të projektit (niveli i fshatrave dhe vendbanimeve); Amvisëri pronare të tokës/amvisëri pranë lokacionit të projektit; Pronarët e bizneseve lokale; Grupet e cenueshme (amvisëritë me të hyra të ulëta, gratë, të moshuarit, të rinjtë veçanërisht NEET, komunitetet RAE, etj.) Agjencitë dhe ministritë e ndryshme kombëtare dhe ndërkombëtare si Operatori i Sistemit të Transmisionit dhe Tregut të Kosovës; Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës; Instituti Arkeologjik i Kosovës; IUCN etj.
I ulët	I ulët Interes	Mesatar - I lartë

5 Programi për Angazhim të Palëve të Interesit

5.1. Detyrat specifike në kuadër të përgatitjes së VNMS-së

TERMOKOS-i synon të ofrojë të gjitha informatat relevante për publikun dhe të mbajë kanale të hapura dhe transparente komunikimi me palët e interesuara dhe të prekura.

Dokumentet e mëposhtme janë dhe do të vihen në dispozicion në gjuhën shqipe, serbe dhe angleze, si më poshtë:

- Përmbledhja Jo Teknike (PJT) e VNMS-së; - dhjetor 2022
- Plani për Angazhim të Palëve të Interesit (PAPI) duke përfshirë Mekanizmin për Ankesa; - në dispozicion prej 13 tetorit 2022
  - Versionin në gjuhën shqipe https://termokos.org/wp-content/uploads/2022/12/221012_SEP-S4K_v8_SQ_REV-3.docx
  - Versionin në gjuhën serbe https://termokos.org/wp-content/uploads/2022/12/SrbN_221012_SEP-S4K_v8-5.docx
  - Versionin në gjuhën angleze https://termokos.org/2022/10/13/stakeholder-engagement-plan/
- Vlerësimi i Ndikimit Mjedisor dhe Social (draft dhe përfundimtar);
- Plani për Menaxhim Mjedisor dhe Social (PMMS).
- Përmbledhja Jo Teknike (PJT) e Kornizës/Planit për Rimëkëmbjen e Mjeteve të Jetesës (KRMJ/PRMJ) – dhjetor 2022

Kopjet fizike të këtyre dokumenteve janë dhe do të vihen në dispozicion për shikim gjatë orarit të punës në ambientet e TERMOKOS Sh.A. (Rr. 28 Nëntori, 181, Prishtinë).

TERMOKOS-i ka hapur një seksion të veçantë të ueb faqes së projektit për Projektin dhe do të përfshijë komunat përkatëse (Prishtinë dhe Obiliq) që të përdorin kanalet e mëposhtme për komunikim të rregullt dhe të drejtpërdrejtë me palët e interesit:

- Ueb faqja zyrtare e projektit e TERMOKOS-it https://TERMOKOS.org/category/solar-4-kosovo/
- Pyetje me telefon, postë, faks ose email në Zyrën për Informim Publik në TERMOKOS info@TERMOKOS.org; dhe email-in e dedikuar solar4kosova@TERMOKOS.org
- Ueb faqja direkte për pyetje publike - https://TERMOKOS.org/kontakti/
- Zyra për marrëdhënie me publikun TERMOKOS (Znj. Afërdita Uka-Fejzullahu, Email: aferdita.uka@TERMOKOS.org);
- Të ndahen me

- Ueb faqja zyrtare e Komunës së Prishtinës, https://prishtinaonline.com/
- Ueb faqja zyrtare e Komunës së Obiliqit, https://kk.rks-gov.net/obiliq/

Njoftimet publike do t'u komunikohen edhe mediave (stacionet radiotelevizive lokale, gazetat e përditshme) si dhe kur janë relevante në vendet/tabelat e komunitetit.

Të gjitha informacionet dhe dokumentet e disponueshme të projektit do t'i shpalosen publikut të paktën 10 ditë përpara takimeve. Gjatë aktiviteteve të kaluara për angazhim të palëve të interesit është vërejtur pjesëmarrje e madhe e burrave dhe mungesë e pjesëmarrjes së grave. Në të ardhmen, AEP-ja dhe EAPI do të marrin të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pjesëmarrje të barabartë të grave dhe grupeve të tjera të cenueshme në proceset e konsultimit dhe angazhimit të projektit. Do të mbahen takime të veçanta në kohën dhe vendin e duhur, për të siguruar që angazhimi i palëve të interesit sipas procesit të jetë i përgjegjshëm gjinor dhe gjithashtu merr parasysh kërkesat e grupeve të cenueshme që duhen identifikuar.

Takimet me publikun/komunitetin do të synojnë ofrimin e informacionit për publikun dhe PPP-të në lidhje me komponentët e planifikuar të projektit. Pjesëmarrësit do të jenë në gjendje të paraqesin mendimet dhe vërejtjet e tyre në lidhje me Projektin, si dhe të sugjerojnë zgjidhje të mundshme për çështjet e ngritura. Përfundimet e takimit do të dakordohen gjatë takimit dhe do të regjistrohen. Për këtë qëllim, do të përdoret formati i paraqitur në Shtojcën 4. Të gjitha komentet dhe propozimet e justifikuara do të shqyrtohen dhe do të adresohen në mënyrë të përshtatshme. NJZP-ja do të publikojë një raport përmbledhës të të gjitha çështjeve relevante të ngritura, duke përfshirë shpjegimet për përfshirjen ose përjashtimin e propozimeve.

5.2. Strategjia e komunikimit për drejtimin e angazhimit të palëve të interesit sipas palëve kyçe të interesit

Tabela 4 më poshtë ofron një strategji të detajuar të komunikimit për të udhëhequr angazhimin e palëve të interesit sipas palëve kyçe të interesit, objektivave të komunikimit, metodave të komunikimit dhe angazhimit dhe Kohës Indikative të Angazhimeve/Konsultimeve.

Tabela 4 - Planet dhe strategjitë për angazhim të palëve të interesit

Nr.	Palë interesi e identifikuar	Qëllimi i komunikimit	Metodat e komunikimit dhe angazhimit	Koha indikative e angazhimeve/konsultimeve
1	**TERMOKOS-i / Njësia e Zbatimit të Projektit** (është *palë kryesore e brendshme e interesit/përfitues i projektit dhe rrjedhimisht pika qendrore e komunikimit dhe angazhimit të palëve të interesit)*	Marrë parasysh rolin e saj qendror, **në raport me akterët e jashtëm,** NJZP-ja do të sigurojë një zbatim të suksesshëm të projektit dhe çdo angazhimi që kërkohet që nga faza e hershme e projektit. Do të sigurojë informacion në kohë për aktivitetet e planifikuara të projektit dhe metodat/mjetet e angazhimit dhe kornizën kohore për të gjithë palët e interesit. Do të sigurojë krijimin dhe zbatimin e mekanizmit për ankesave dhe të jetë përgjegjës për të gjitha proceset e monitorimit dhe raportimit	**Palët e jashtme të interesit -** Mjetet - PAPI, dokumentet e ankesave, draftet dhe dokumentet përfundimtare të VNMS-së që do të shpalosen, dokumentet e raportimit, fletët e fakteve, njoftimet publike, raportet për mediat, prezantimet, Informacion dhe komunikim përmes - ueb faqes, rrjeteve sociale, korrespondencës, vizitave në lokacion, takimeve individuale dhe publike me palë të interesit/komunitetin, punëtori, lista postimi **Të brendshme** - Dokumentet, raportet, politikat, takimet individuale dhe me departamentin, korrespondenca dhe të dhënat, vizitat në terren Informacion nga përfaqësuesit në terren/në lokacion lidhur me sa vijon: politikat e burimeve njerëzore; mekanizmi i brendshëm për ankesa; procedurat e shëndetit dhe sigurisë; kodet e sjelljes; Zbatimi i masave për VNMS, PMMS, PRMJ PAPI; Mekanizmi i ankesave i PAPI	Nëntor 2021 - Shtator 2022 - Gjatë VNMS-së mbështetur nga ekipi i konsulencës Gjatë gjithë zbatimit të projektit (të gjitha fazat e projektit nga NJZP)

Nr.	Palë interesi e identifikuar	Qëllimi i komunikimit	Metodat e komunikimit dhe angazhimit	Koha indikative e angazhimeve/konsultimeve
		Kundrejt palëve të brendshme të interesit (NJZP e TERMOKOS-it, Ekipi i Konsulentëve, KfW - Informojnë grupin për: • Kapacitetet e brendshme dhe planet për ngritjen e kapaciteteve për të gjitha kërkesat e Projektit, veçanërisht në lidhje me Zbatimin e PAPI-t dhe të gjitha masat e përshkruara në politikën e burimeve njerëzore të PMMS-së, mekanizmin për ankesa, procedurat e shëndetit dhe sigurisë, kodet e sjelljes, standardet SMS të KfW/BB dhe KP-të e BERZH-it.		
2	**1. Popullata lokale nga komunat e prekura** dhe Komunitetet **me qasje të drejtpërdrejtë në furnizimin me ngrohje solare** (Përfitues që marrin shërbim nga sistemi i ngrohtores së qytetit - Prishtina Jug dhe Përfituesit e mundshëm - Do të kyçen në sistemin e ngrohtores së qytetit - Prishtinë Tophane) **2.** Komuniteti **përgjatë gjurmës së tubacionit** në Obiliq dhe Prishtinë **3. Popullata lokale pranë impiantit solar dhe deponimit të gropës që është paraparë** të ndërtohet në një parcelë të pazhvilluar pranë autostradës M2 ndërmjet Prishtinës dhe Obiliqit. Pranë lokacionit janë	Informacion për natyrën e Projektit, kohëzgjatjen e Projektit, ndikimet e mundshme në mjedis, social dhe ekonomi, Përgatitja për anketat socio-ekonomike/regjistrimi në fshatrat e prekura dhe identifikimi/informimi i strategjisë për anketat. Mundësitë që komuniteti të përfshihet aktivisht në përgatitjen ose zbatimin e Projektit. Mekanizmat për shqetësime dhe ankesa.	Informimi nëpërmjet njoftimeve të ndryshme) (p.sh. ueb faqe, rrjete sociale, broshura/fletëpalosje të printuara Informim direkt përmes Komunave të Prishtinës dhe Obiliqit. Informacion i drejtpërdrejtë nëpërmjet një personi kontakti ose personi përgjegjës për zbatimin e PAPI-t. Takime publike në qendra komunale apo fshatra Në metodat e angazhimit do të përdoren strukturat ekzistuese të komunitetit (p.sh. këshilltarët dhe përfaqësuesit e fshatrave). Anketa të mostrimi/ Takime individuale/ angazhimet online me familjet e prekura drejtpërdrejt gjatë anketave/regjistrimit socio-ekonomik. Komunikimi përmes tabelave për njoftime (të vendosura në vende të përshtatshme në komunitet) dhe vendosja e informacionit/njoftimeve të projektit atje.	1) Fillimisht përmes anketave bazë të ndikimit social (prill-maj 2022), 1-4) Takime informuese dhe konsultative të zhvilluara në korrik 2022 dhe në fazat e mëvonshme Informacione rreth Projektit (p.sh. VNMS, PAPI, formulari për ankesa) të publikuara në ueb faqen e TERMOKOS-it dhe rrjete të tjera sociale gjatë gjithë zbatimit të Projektit/

Nr.	Palë interesi e identifikuar	Qëllimi i komunikimit	Metodat e komunikimit dhe angazhimit	Koha indikative e angazhimeve/konsultimeve
	si monumenti i Gazimestanit të pakicës ortodokse serbe dhe Tyrbja e Bajraktarit. **Popullata e Hades së Re** Të zhvendosur së fundi, ose në proces të zhvendosjes nga fshatrat e tjera të Obiliqit në zonën e banimit në jug të zonës së Projektit. **Përdoruesit formalë dhe informal të tokës/fermerët**		Do të kryhen Konsultime dhe informacioni i përgatitur do të jetë përgjithësisht në gjuhën shqipe dhe në gjuhë të tjera lokale sipas nevojës	
3	**Grupet e cenueshme**: komunitetet RAE dhe pakicat e tjera etnike gra të rinj NEET të tjerë që mund të identifikohen gjatë zbatimit të projektit	Grupet e cenueshme dhe të margjinalizuara do të shtohen siç identifikohen përmes anketës/regjistrimit socio-ekonomik dhe procesit të PRMJ-së Qëllimi është të aplikohen metoda të targetuara angazhimi për grupet potencialisht të cenueshme dhe të margjinalizuara, në mënyrë që ata të kenë qasje në informacionin e projektit dhe të mund të marrin pjesë në procesin e angazhimit. Qëllimi është të sigurohet që grupe të tilla të mos preken në mënyrë disproporcionale nga Projekti dhe masat specifike të ndihmës mund të identifikohen dhe zbatohen nëse është e nevojshme. Informimi i grupeve të cenueshme për aktivitetet dhe investimet e planifikuara të projektit	Metodat do të përpunohen për këtë grup pas anketave socio-ekonomike Mekanizmat dhe qasjet e duhura kulturore për t'u angazhuar me gratë/ RAE/pakicat në fshatra që mund të mos dëshirojnë të marrin pjesë në takime publike. NJZP-ja do të kërkojë mbështetjen dhe këshilla prej komunave lokale që angazhohen me këto komunitete, OJQ-ve dhe përfaqësuesve të zgjedhur të fshatrave dhe (për aq sa të jetë e mundur) do të shfrytëzojë metodat dhe kanalet ekzistuese të angazhimit me këto grupe si fokus grupet e grave, fokus grupet RAE. • Informacioni i publikuar në tabelat e njoftimeve • Njoftime për shtyp në mediat e targetuara të pakicave etnike	Një mekanizëm kyç për angazhimin me grupet/personat e cenueshëm është anketa/regjistrimi socio-ekonomik në maj/qershor 2022.

Nr.	Palë interesi e identifikuar	Qëllimi i komunikimit	Metodat e komunikimit dhe angazhimit	Koha indikative e angazhimeve/konsultimeve
		Ofrimi i informacionit në kohë për nevojën për t'u përshtatur me kushtet e përkohshme dhe të reja të jetës që rrjedhin nga aktivitetet e (nën)projektit Përfshirja sociale e grupeve të cenueshme në zonën e prekur të projektit		
4	**Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës**	Pranimi dhe konsultimi për informacionin relevant për bazën e VNMS-së dhe përgatitjen e VNMS-së dhe aprovimet/opinionet e tjera të nevojshme. Siç janë Pëlqimi për shfrytëzimin e tokës Aprovimi për ndarjen e truallit Pëlqimi mjedisor Deklarata e Vlerësimit të Ndikimit Mjedisor dhe Social Deklaratë nga Agjencia e Kosovës për Mbrojtjen e Mjedisit Leje për Kushtet e Ndërtimit Fleta Poseduese Vendimi Përfundimtar për Shpronësimin Realizimi me sukses i projektit Arritja e pajtueshmërisë me kërkesat e KfW /	Korrespondenca zyrtare. Takime të drejtpërdrejta. Vizitat në vend Dëgjesa/takime publike.	Rregullisht gjatë gjithë zbatimit të Projektit
5	**Qeverisjet Lokale (Komunat e Prishtinës dhe Obiliqit)**	Planifikimi dhe zbatimi i projektit. Përfshirë marrëveshjet për përdorimin e tokës, sipërfaqen e projektit, tubacionet lidhëse etj.	Korrespondenca zyrtare dhe takime të rregullta të përditësimit. Ftesa për përfaqësuesit e komunës në Takimin Publik dhe mbajtja e tyre të përditësuar për takimet me anëtarët e	Gjatë VNMS-së bazë, shpalosja e VNMS-së, anketat; Gjatë gjithë zbatimit të projektit

Nr.	Palë interesi e identifikuar	Qëllimi i komunikimit	Metodat e komunikimit dhe angazhimit	Koha indikative e angazhimeve/konsultimeve
		Diskutimi dhe dakordimi mbi metodat më të mira për angazhimin e komunitetit si pjesë e PAPI-t dhe anketave Lehtësimi i konsultimeve publike. Mbështetje me anketa socio-ekonomike dhe angazhime me komunitetet lokale, duke përfshirë grupet e cenueshme dhe të margjinalizuara	grupet e cenueshme etj. Komunikimi përmes tabelave të njoftimeve (të vendosura në qendrat e komunave dhe fshatra dhe zona publike të caktuara).	
6	Këshilli Monitorues i Zbatimit (KMZ).	Përbërja e KMZ-së: 1) MMPHI, 2) Ministria e Kulturës, 3) Delegacioni i BE-së, 4) OSBE dhe 5) Kisha Ortodokse Serbe Të informojë përkatësisht anëtarët statutore të KMZ-së, veçanërisht kishën serbo-ortodokse si dhe përfaqësuesit e Komunitetit Mysliman, në lidhje me kufijtë e Zonës së Veçantë të Mbrojtur të Gazimestanit me gjurmë të projektit.	Korrespondenca dhe takime formale	Bazuar në sqarimin e kufijve të projektit/ gjurma nga studimi i fizibilitetit (gusht)
7	**Autoritete të tjera relevante qeveritare, ministri, agjenci dhe institucione publike**	• Konsultimet me autoritetet përkatëse qeveritare në lidhje me aktivitetet e projektit (ofruesit e të dhënave dhe vërtetimi i të dhënave) në kuadër të procesit të VNMS-së • Raportimi bazuar në kërkesat e legjislacionit kombëtar • Sigurimi i pjesëmarrjes efikase të të gjitha palëve të interesit gjatë gjithë projektit	• Takime individuale konsultative • Konsultimi publik. Shpalosja e dokumenteve dhe reagimet sipas rastit • Deklarata për media/shtyp, Përmbledhje • Komunikimi i drejtpërdrejtë (takime dhe shkëmbim e-mail dhe korrespondencë zyrtare)	Gjatë VNMS-së bazë, dhe Shpalosjes Sipas nevojës në fazat e ardhshme të projektit

Nr.	Palë interesi e identifikuar	Qëllimi i komunikimit	etodat e komunikimit dhe angazhimit	Koha indikative e angazhimeve/konsultimeve
	Ministria e Punëve të Brendshme	- Pëlqimi për planin e menaxhimit të trafikut nga Policia e Kosovës • Pëlqimi nga Agjencia e Menaxhimit Emergjent	Komunikimi i drejtpërdrejtë (takime dhe shkëmbim e-mail dhe korrespondencë zyrtare)	Gjatë Fazës së Ndërtimit
	Ministria për Forcën e Sigurisë së Kosovës	• Pëlqimi për Kushtet e Qendrës së Veprimit Kundër Minave	• Komunikimi i drejtpërdrejtë (takime dhe shkëmbim e-mail dhe korrespondencë zyrtare)	Procedura që mund të kërkohet para ose gjatë fillimit të punimeve ndërtimore në lidhje me municionet e pashpërthyera
	Instituti Arkeologjik i Kosovës	• Pëlqimi arkeologjik	• Komunikimi i drejtpërdrejtë (takime dhe shkëmbim e-mail dhe korrespondencë zyrtare)	Gjatë VNMS-së
8	**Organizata të interesuara joqeveritare (OJQ) dhe Organizata të Shoqërisë Civile (OSHC)** **Shënim**: Çdo organizatë e interesuar në projekt mund të dërgojë detajet e tyre të kontaktit në NJZP për t'u përfshirë në *tabelën e OJQ-ve* të paraqitur në Shtojcën 5 të këtij KAPI-i dhe për t'u njoftuar drejtpërdrejt për ngjarjet e Projektit.	• Sigurimi i informacionit, komunikimit dhe konsultimeve në kohë për t'i përshtatur aktivitetet e projektit sipas nevojave të komuniteteve lokale, grupeve të margjinalizuara dhe të cenueshme dhe mjedisit lokal. • Informimi i OJQ-ve kombëtare dhe lokale për aktivitetet e Projektit dhe marrja e reagimeve për dokumentet e shpalosura	Takime për konsultim publik, dhe takime konsultative individuale sipas nevojës Komunikim i drejtpërdrejtë me email Media/ njoftime për shtyp/ rrjete sociale Informacion rreth Projektit (p.sh. dokumentet e shpalosura për VNMS, PAPI dhe PRMJ)	• Gjatë prezantimit të projektit • Gjatë VNMS-së bazë, Shpalosjes së VNMS-së • Gjatë gjithë zbatimit të Projektit.

5.2.1. Strategjia e komunikimit gjatë Fazës Ndërtimore

Gjatë fazës së ndërtimit, objektivi do të jetë sigurimi i zbutjes dhe informacionit mbi ndikimet e projektit në shëndetin dhe sigurinë e komunitetit, menaxhimin e kontraktorëve të mundshëm, menaxhimin e sistemit të ankesave dhe zbutjen e problemeve që lidhen me ndërtimin si zhurma dhe trafiku.

Termokos-i do të mbikëqyrë dhe do të sigurojë që çdo Kontraktor i përgatit Marrëdhënie me Komunitetin dhe Informacionin me një procedurë të qartë për ndërveprim me palët e interesit dhe bën mbledhjen e reagimeve dhe sugjerimeve për çështjet që kanë të bëjnë me ndërtimin. Reagimet rreth aktiviteteve të ndërtimit, si rekomandimet e projektimit apo shqetësimet për qasjen, do të trajtohen sipas kësaj procedure dhe do të monitorohen nga Termokos-i.

Tabela 5 - Aktivitetet për angazhim të palëve të interesit gjatë fazës ndërtimore

Nr.	Palë interesi e identifikuar	Qëllimi i komunikimit/aktivitetit	Metodat e komunikimit dhe angazhimit
1	Të gjitha zonat/komunitetet e prekura dhe palët e interesuara	Shpalosja e informacionit për: • Qëllimin dhe llojin e veprimtarisë ndërtimore • Paralajmërim i hershëm për datën e fillimit, kalendarin dhe kohëzgjatjen e ndërtimit • Efektet e mundshme dhe masat/mekanizmat për shëndet dhe siguri	Personi i kontaktit i disponueshëm në vendpunishte gjatë punimeve dhe detajet e kontaktit të tij të shfaqura dukshëm në hyrje të lokacionit Shenjat paralajmëruese të vendosen përpara fillimit të aktivitetit ndërtimor, duke përfshirë një numër kontakti të drejtpërdrejtë të mbikëqyrësit të ndërtimit Vizitat të rregullta në lokacion, Raportet Vjetore të Monitorimit Mjedisor dhe Social Mekanizmi për ankesa dhe kutitë për sugjerime të vendosura në vendpunishte Pankarta të vendosura në ndërtesa publike, zona dhe vendpunishte ndërtimi Ueb faqja e projektit Ueb faqja e Komunës
2	Të gjitha zonat / komunitetet e prekura dhe palët e interesuara; Autoritetet lokale, institucionet e shërbimit publik, bizneset lokale	• Njoftim për çdo ndërprerje në transport. • Njoftimi i aktivitetit të ndërtimit, mbyllja e rrugëve, transporti/qasja e këmbësorëve etj. • Njoftimi i subjekteve publike të ngarkuara me ofrimin e shërbimeve në mënyrë që të kenë dijeni për trafik të rënduar apo zona ndërtimi. • Informacion për çdo aktivitet që mund të shkaktojë shqetësim në nivel lokal, si zhurma dhe dridhjet e ndërtimit	Pankarta informative të vendosura në vendpunishte ndërtimore Vendosja e shenjave të trafikut dhe paralajmëruese në lidhje me aktivitetin ndërtimor, duke përfshirë një numër kontakti të drejtpërdrejtë të mbikëqyrësit të ndërtimit Përdorimi i rrjeteve sociale për të mbuluar zonat e targetuara Përdorimi i mediave lokale si radio, TV, gazeta etj. Pankarta për të paraqitur kalendarin e ndërtimit, mbylljet e rrugëve dhe masat që duhen marrë parasysh Ndërtesa publike dhe private, vendpunishte ndërtimore dhe ndërtesa komunale Mekanizmi për ankesa - kutitë për komente/ankesa Monitorimi i zhurmës/trafikut dhe adresimi i rasteve të lidhura me ankesat përmes mbledhjes së reagimeve nga ankuesit
3	Të gjitha zonat e prekura nga projekti, palët e interesuara dhe punëtorët e projektit	Mekanizmi për reagime dhe ankesa për Termokos (MSHS) dhe Kontraktorët (nënkontraktorët) • Trajnim për procedurat për ankesa • Procesi i zgjidhjes së ankesave (përfshirë përgjigjen ndaj çështjeve të sigurisë, ndërtimit ose kontraktorit)	Reklama për Mekanizmin për Ankesa përmes ueb faqes së projektit, pankartave të projektit, fletëpalosjeve Telefonata direkte, email dhe takime sy më sy, vizita në terren.

Nr.	Pa lë interesi e identifikuar	Që llimi i komunikimit/aktivitetit	Me todat e komunikimit dhe angazhimit
		• Ofrimi i trajnimeve për politikat e Kontraktorit (punonjësit dhe kontraktorët) mbi sjelljet e respektueshme dhe të përshtatshme me komunitetet • Sigurimi që kontraktorët t'i kenë në funksion mekanizmat për ankesa	
4	Të gjitha zonat e prekura	• Të sigurohet nga Termokos-i dhe ekipet e kontratës/prokurimit/BNJ të kontraktorit • Praktikat dhe planet e rekrutimit dhe prokurimit, • Punësimi i Punëtorëve Lokalë • Siguria dhe Shëndeti në Punë • Politikat për rekrutim të punonjësve nga zonat e prekura duke përfshirë grupet e cenueshme • Prokurimi i furnizimeve dhe shërbimeve	Ueb faqja e Termokos-it, Kontraktorit, Komunave Kontaktet me zyrat lokale të punësimit Gazeta pankarta/fletëpalosje në zonat e prekura
5	Të gjitha zonat / komunitetet e prekura	• Zhvillimi, zbatimi dhe mbajtja të informuar • komunitetin lokal për: • Mekanizmat për Ankesa • Planin për Shëndetin dhe Sigurinë e Komunitetit • Planin Lokal të Prokurimit • Planin e Menaxhimit të Trafikut	Ueb faqja e Termokos dhe Kontraktorit, masmedia, tabelat lokale të njoftimeve në zonat e prekura dhe objektet e komunave.

5.2.2. Strategjia e komunikimit gjatë Fazës së Funksionimit

Angazhimi i palëve të interesit në fazën e funksionimit ka për qëllim të informojë publikun për efektet e mundshme operacionale dhe të sigurojë aftësinë e TERMOKOS-it/AEP-së për zbatimin e suksesshëm të PAPI-t.

Tabela 6 - Aktivitetet për angazhim të palëve të interesit gjatë fazës së funksionimit

Nr.	Palë interesi e identifikuar	Qëllimi i komunikimit/aktivitetit	Metodat e komunikimit dhe angazhimit
1	Të gjitha zonat/komunitetet e prekura dhe palët e interesit	• Përditësim dhe zbatim i • PAPI, Mekanizmi për ankesa, Plani për Mjedis, Shëndet dhe Siguri • Zhvillimi dhe publikimi i Raportit Vjetore të Monitorimit Mjedisor dhe Social	Shpalosja e dokumenteve të përditësuara do të ndahet përmes ueb faqes/ rrjeteve sociale, dhe kopjet e tyre fizike do të jenë në dispozicion në zyrat komunale dhe zyrën e Termokos-it. PAPI i përditësuar Raportet për ankesat Kontakti me personat përgjegjës Raportet e monitorimit

5.3.

5.4. Angazhimi i mëparshëm i palëve të interesit dhe aktivitetet e konsultimit

Aktivitetet e konsultimit të ndërmarra gjatë fazës së hershme të VNMS-së (Faza fillestare nëntor 2021-maj 2022) u përqendruan në identifikimin e kapaciteteve të NJZP-së për të kryer procesin e angazhimit të palëve të interesit si dhe në marrjen e informacionit esencial për dizajnin e projektit të planifikuar dhe në zonën e projektit për Vlerësimin Bazë Mjedisor dhe Social.

Tabela 5 më poshtë ofron një përmbledhje të konsultimeve dhe aktiviteteve individuale të angazhimit të ndërmarra gjatë kësaj faze.

Tabela 7 - Aktivitetet e angazhimit të palëve të interesit gjatë fazës së VNMS-së (nëntor 2021- maj 2022)

Data	Lloji i angazhimit / konsultimit	Pala e interesit	Vendi	Qëllimi i angazhimit/konsultimit
18/05/2022	Konsultimi	Komuna e Prishtinës, Drejtoria e Kadastrës	Mjediset e Komunës së Prishtinës	Informim i Komunës për procedurën e VNMS-së Gjetja e zgjidhjeve për shpalosjen e të dhënave kadastrale përgjatë shtrirjes paraprake të tubacionit Kërkesë për pikë të vetme kontakti për projektin S4K brenda administratës komunale (nënkryetari?) Informim për statusin e MM-së mes komunave t[Prishtinës dhe Obiliqit.
04/05/2022	Takim	Edona Gashi-Durguti, Drejtoreshë e Qendrës Rajonale për Trashëgimi Kulturore-Prishtinë (QRTKP).	Mjediset e QRTKP-së	Qëllimi i takimit ishte i dyfishtë: **1.** të informojë QRTKP-në për rezultatet e projektit dhe aktivitetet e parashikuara dhe të shikohet nëse ka nevojë që ata të informohen dhe/ose të përfshihen rregullisht në aktivitetet e projektit; **2.** të merret çdo kontribut relevant i nevojshëm për plotësimin e bazës së VNMS-së dhe masat e propozuara për të zbutur çdo efekt të mundshëm në monumentet e trashëgimisë kulturore.
22/04/2022	Shpallja për publikun për fillimin e procesit të anketimit socio-ekonomik	Publiku i përgjithshëm	Përmes ueb faqes së TERMOKOS-it Postera në ndërtesa publike	Shpallja për publikun e gjerë e Anketave me informacion në ueb faqe/broshurë për anketën socio-ekonomike https://termokos.org/2022/04/22/njoftim-per-mbledhjen-e-te-dhenave-baze-socio-ekonomike/ në 3 gjuhët (EN, AL, SR),

Data	Lloji i angazhimit / konsultimit	Pala e interesit	Vendi	Qëllimi i angazhimit/konsultimit
21/03/2022 22/03/2022	Takimet	TERMOKOS, MMPHI, Komuna e Obiliqit, Ekipi i Projektit të Unazës, Komuna e Prishtinës, Ekipi konsulent i VNMS-së	Komuna e Obiliqit	Diskutim i çështjeve të punimeve ndërtimore në vazhdim që bien ndesh me zonën e projektit. Diskutimi i çështjeve të pronësisë së tokës së projektit dhe personave/institucioneve të mundshëm të prekur siç janë pronarët e parcelës pranë Tyrbes, diskutimi për heqjen e varreve ekzistuese të Hades së Re (6 prej tyre, por edhe ato që mund të zhvillohen në të ardhmen) dhe kërkimi i lokacionit të ri për ta dhe xhaminë; Diskutimi i planeve dhe përgjegjësive për organizimin e një debati publik me qytetarët e Hades së Re për t'i informuar ata për vendimin e ri.
15/03/2022	Takim	TERMOKOS, MMPHI, Komuna e Obiliqit, Komuna e Prishtinës, Ekipi konsulent i VNMS-së	Komuna e Obiliqit	Përshkrim i shkurtër i qëllimit dhe karakteristikave teknike të projektit. Diskutim i disa çështjeve ndërmjet palëve të cilat do të mundësonin zhvillimin e studimit për projektin "Solar4Kosovo II / Ngrohtorja Solare". Diskutimi i pronësisë së parcelave të projektit ndërmjet MMPHI-së dhe 2 komunave.
14/03/2022	Angazhimi	PPP - Rezident/Person i zhvendosur	Hade e Re, pronari më verior i shtëpisë përballë Fushës së Sportit	Sigurim i mbështetjes për instalimin dhe sigurinë e 3 kupave për mostrim të pluhurit
15/23/25 shkurt 2022	Korrespondencë/Letra	TERMOKOS-i për Komunat e Prishtinës dhe Obiliqit		Kërkesë për informacion kadastral për lokacionin e projektit dhe tubacionet
08/02/2022	Takim	Instituti për Mbrojtjen e Mjedisit	Instituti për Mbrojtjen e Mjedisit	Marrja e informacionit mbi statusin e Zonës së Mbrojtur të Gazimestanit (Kategoria IUCN I)
19/01/2022	Takim	MMPHI: Afrim Murati, Yllka Gashi, Ekipi i Konsulentëve të VNMS-së: Lumnije Gashi-Shabani dhe Sadije Deliu	MMPHI	Takim me Departamentin për Shpronësime për të marrë informacion mbi Planin Rregullator Urbanistik për Haden e Re
09/11/2021	Angazhimi	PPP - Përdorues i tokës bujqësore në lokacionin e projektit	Mazgit	Ka aprovuar kryerjen e shpimeve gjeoteknike dhe gërmimeve në gropë provë me nënshkrim
09/11/2021	Angazhimi	PPP - Përdorues i tokës bujqësore në lokacionin e projektit (grurë)	Mazgit	

5.5. Aktivitete të tjera të PAPI-t në vazhdim dhe të planifikuara gjatë periudhës së VNMS-së në vitin 2022

Për sa i përket angazhimit të palëve të interesit, në vazhdim dhe të planifikuar nga maji 2022 deri në shtator 2022, janë përmbledhur në *Tabelën 6.*

Tabela 8 - Angazhimi i palëve të interesit - Pasqyrë e aktiviteteve në vazhdim dhe të planifikuara

Faza	Objektivi i angazhimit	Aktivitetet[18]	Informacioni që duhet ndarë dhe mjetet	Produktet e pritura	Afati kohor i planifikuar
Angazhimi i palëve të interesit gjatë Studimit Bazë për Ndikimin Social (SBNS)	Synon dakordimin mbi aspektet dhe ndikimet që do të trajtohen dhe analizohen në studimin e VNMS-së Palët e interesit informohen dhe konsultohen për dizajnin dhe lokacionin e projektit, dhe për të kuptuar pikëpamjet dhe shqetësimet e palëve të interesit në lidhje me projektin Palët e interesit konsultohen për të vërtetuar të dhënat përkatëse mjedisore, socio-ekonomike dhe të trashëgimisë kulturore. Gjithashtu, palët e interesit konsultohen edhe për mënyrat më të mira për t'u angazhuar gjatë VNMS-së dhe pasqyrohen në dokumentin e PAPI-t. Palët e interesit mund të komentojnë për VNMS-në bazë dhe masat zbutëse dhe menaxhuese për ndikimet dhe risqet dhe të japin kontribute për dokumentet	Përmes formave të ndryshme: Takime me palët e interesit dhe takime të unifikuara në grup me të gjitha grupet e interesuara Për shkak të shqetësimeve të vazhdueshme për sigurinë shkaku i koronavirusit, modalitetet e konsultimit janë përshtatur për të përdorur më shumë mënyra të rrjeteve sociale për shkëmbim të komunikimit, si p.sh. email, mjetet e takimeve online Microsoft Teams Meeting, Zoom, etj., dhe kur është e përshtatshme takime sy më sy	Nga TERMOKOS-i dhe me mbështetje nga ekipi i konsulentëve ❖VNMS bazë ❖Përmbledhje jo-teknike ❖KAPI shpaloset përmes ueb faqes së TERMOKOS-it dhe kopjet e printuara u dërgohen palëve të interesit të identifikuara si të ndikuar potencialisht ose që kanë interes në Projekt. Një njoftim do të bëhet në gjuhën shqipe dhe nëse është e nevojshme në gjuhën serbe dhe turke, për gazetat lokale dhe kombëtare për t'i bërë të ditur publikut se ku mund t'i qasen raportit dhe si mund të japin komente.	Opinioni i palëve të interesuara në aspektet mjedisore dhe sociale duhet trajtuar nga propozuesi i projektit dhe nëse ka nevojë për të trajtuar aspekte shtesë Palëve të interesit iu dha një mundësi për të dhënë pikëpamjet e tyre në lidhje me planet për aktivitetet e ardhshme të angazhimit, duke përfshirë çdo preferencë për metodat, materialet dhe kalendarin.	Përmbledhje e projektit dhe PAPI - prill 2022 Sesionet informative të projektit në Prishtinë (korrik 2022) Obiliq (pas nënshkrimit të Memorandumit të Mirëkuptimit) VNMS Përmbledhja bazë dhe jo teknike e shpalosur për 30 ditë në TM4 2022

[18] Detaje të mëtejshme (metodat e komunikimit dhe angazhimit sipas grupit të palëve të interesit) do të raportohen në përditësimin e ardhshëm të PAPI-t.

Faza	Objektivi i angazhimit	Aktivitetet	Informacioni që duhet ndarë dhe mjetet	Produktet e pritura	Afati kohor i planifikuar
Angazhimi i palëve të interesit gjatë Studimit Bazë për Ndikimin Social (SBNS)	1. Palët e brendshme të interesit janë të informuar dhe konsultohen për hartimin dhe komponentët kryesorë të studimit dhe do t'u jepet mundësia të ndajnë pikëpamjet, shqetësimet dhe të dhënat e tyre. 2. PPP-të e projektit, komunitetet e prekura dhe publiku i gjerë janë të informuar për qëllimin, rëndësinë, natyrën dhe afatin kohor të anketës(ave). 3. Palët e brendshme të interesit janë të informuar në kohë për gjetjet kryesore të studimit.	*1. Anketat e finalizuara ndahen me palët e brendshme të interesit (veçanërisht TERMOKOS-in, komunat e Obiliqit dhe Prishtinës, etj.) dhe atyre u kërkohet të japin komentet/inputet e tyre brenda një afati kohor të caktuar.* *3. Njoftimi publik i studimit: Dy javë para fillimit të punës në terren, njoftimet e anketës do të bëhen publike nëpërmjet kanaleve dhe vendeve të ndryshme.* *3. Takim me palët e brendshme të interesit ku do të ndahen dhe prezantohen gjetjet kryesore të studimit.*	*1. Anketat ndahen me palët e brendshme të interesit me email. Palëve të interesit u jepen 7 ditë pune për t'i shqyrtuar dhe dorëzuar çdo koment në lidhje me përmbajtjen e anketës. Nëse konsiderohet e realizueshme, mund të organizohet një takim për të diskutuar dhe finalizuar çdo ndryshim që mund të ndodhë gjatë periudhës së shqyrtimit.* *2. Njoftimet e anketës publike duhet të përfshijnë të paktën informacionin e mëposhtëm:* *Emri dhe informatat kontaktuese të organizatës që kryen anketën (d.m.th. TERMOKOS);* *Informacioni i konfidencialitetit dhe mënyra se si do të përdoren të dhënat e mbledhura;* *Kohëzgjatja e anketës; Një përshkrim i shkurtër i qëllimit dhe rëndësisë së studimit;* *Udhëzime se si do të kryhet anketa* *dhe kur.* *Mjetet për shpalosje të informacionit që do të përdoren përfshijnë:* *Shpërndarje të materialeve të shtypura informative si fletëpalosje, broshura dhe fletë të dhënash, të përshtatura me nivelin e gjuhës dhe njohurive lokale* *Postera dhe/ose tabela njoftimesh të vendosura në vende të dukshme dhe lehtësisht të qasshme të frekuentuara nga publiku lokal, duke përfshirë mugë shumë të frekuentuara, ndërtesa të administratës lokale, shitore, shkolla, qendra kulturore dhe sportive, zyra postare, parqe, etj.* *Informatat kyçe të shpalosura në ueb faqet zyrtare të komunave të Prishtinës dhe Obiliqit, ministrive relevante dhe TERMOKOS-it*	*1. Palëve të interesit u jepet mundësia të shqyrtojnë dhe të propozojnë çdo ndryshim në anketat përpara se ato të shpallen publikisht dhe përpara se të filojë puna në terren.* *2. PPP-të dhe popullata e përgjithshme janë të informuar për qëllimin, rëndësinë dhe natyrën e anketës dhe ata e kuptojnë pse pjesëmarrja e tyre është e rëndësishme.* *3. Palët e interesit janë të informuar në kohë për gjetjet e anketës dhe se si këto gjetje do të përdoren më tej për qëllime të lidhura me projektin.*	*Prill 2022 - Dy javë para fillimit të punës në terren* *Filluar* *Maj 2022 - Mbledhja e të dhënave të anketës* *Qershor 2022 - Anketa është përfunduar* *Korrik 2022 - Shtator 2022* *Raporti i* ***hartuar në tetor 2022***

Faza	Objektivi i angazhimit	Aktivitetet	Informacioni që duhet ndarë dhe mjetet	Produktet e pritura	Afati kohor i planifikuar
			• Njoftime mediatike nëpërmjet reklamave të shtypura, radiofonike dhe televizive kombëtare • Postime në rrjetet sociale (Facebook, Instagram, faqet në YouTube të komunave të Prishtinës dhe Obiliqit, ministrive relevante dhe TERMOKOS-it) • Sesione informuese sy më sy me komunitete të përzgjedhura • Komunikimi gojë më gojë i lehtësuar nga OJQ-të relevante dhe rrjetet e komunitetit 3. Do të përgatitet një prezantim me gjetjet kyçe të anketës dhe do të prezantohet në një takim me palët e brendshme të interesit.		

Angazhimi për Raportin e VNMS-së	Konsultimet janë ndërmarrë për studimin për të shpalosur rezultatet e tij dhe për t'u dhënë palëve të interesit mundësinë për t'u siguruar që pikat e treguara në takimet bazë të VNMS-së janë adresuar në studim.	mbahet mbledhja e unifikuar (dëgjesa). Në takim marrin pjesë përfaqësues të të gjitha palëve të interesuara, dhe minimalisht ata që kanë marrë pjesë në takimet dhe konsultimet për nivelin bazë. Shpalosja e Raportit të VNMS-së për shqyrtim dhe komente Shpallja publike i Raportit të VNMS-së Shpalosja dhe periudha e komenteve -	Nga TERMOKOS-i dhe me mbështetje nga ekipi i konsulentëve **Draft VNMS-ja** do të prezantohen rezultatet e studimit dhe Prezantimi i masave zbutëse **Dokumenti për KAPI / PAPI është përditësuar**	Opinioni i palëve të interesuara në aspektet mjedisore dhe sociale duhet trajtuar nga propozuesi i projektit dhe nëse ka nevojë për të trajtuar aspekte shtesë Identifikimi i veprimeve të mundshme që duhen ndërmarrë për ta finalizuar studimin	Shpalosja për 30 ditë në TM4 2022 **PAPI versioni 8 i botuar në tetor 2022 në ueb faqe të dedikuara në anglisht, shqip dhe serbisht** Komentet e takimeve publike për draft VNMS-në janë pjesë e dokumentit të PAPI-t

Faza	Objektivi i angazhimit	Aktivitetet	Informacioni që duhet ndarë dhe mjetet	Produktet e pritura	Afati kohor i planifikuar
		Takime me palët e interesit, duke përfshirë takimet me komunitetin aty ku është e nevojshme Mbledhja e inputeve nga palët e interesit për VNMS-në dhe masat e planifikuara zbutëse dhe të përmirësimit. Përgjigje në të gjitha komentet e marra			

5.4.1. Aktivitetet të përfunduara për informim të publikut

Bazuar në dokumentin për PAPI, janë kryer këto aktivitete:

- Ueb faqja e lansuar nga TERMOKOS bazuar në këshillat e Konsulentit më 29 mars (https://termokos.org/category/solar-4-kosovo/
- Përshkrimi i shkurtër jo teknik i projektit për ueb është publikuar në ueb faqen e Termokos-it https://termokos.org/2020/01/24/viti-2019-me-si-suksesshmi-ne-historine-e-termokos-it/
- Broshurë informative në lidhje me SBNS-në si dhe njoftimin dhe informimin mbi Ankesat/Formulari i Ankesave Publike i hartuar dhe publikuar në ueb faqe dhe rrjete sociale më 22 prill (shih Figurën 5 dhe seksionin 5.4.3.)
- Janë ndarë lajme për media dhe informacione për në lidhje me projektin:
  - https://termokos.org/2022/03/25/kriiohen-parakushtet-per-realizimin-e-proiektit-per-energiine-solare/
  - https://termokos.org/2019/11/12/shqyrtohen-mundesite-per-aplikimin-e-ngrohjes-solare-per-prishtinasit-2/
  - https://termokos.org/2022/05/10/shperndahen-broshurat-informuese/
  - https://prishtinainsight.com/kosovo-hails-solar-energy-project-as-potential-game-changer/
  - https://balkangreenenergynews.com/prishtina-district-heating-company-to-build-70-mw-solar-thermal-plant/
  - https://www.districtenergy.org/blogs/district-energy/2022/03/30/prishtinas-district-heating-company-to-build-70-mw
  - https://renewablesnow.com/news/ebrd-mulls-225-mln-euro-loan-to-kosovo-for-solar-heating-project-784030/
  - https://termokos.org/2020/01/24/viti-2019-me-si-suksesshmi-ne-historine-e-termokos-it/
- Dy takime publike për informacionin e VNMS dhe PAPI të mbajtura më 21 dhe 22 korrik (shih seksionin 5.4.2. për VNMS-në më poshtë dhe Aneksin 10.6 - Takimet e konsultimit për VNMS/PAPI të 21-22 korrikut 2022)

5.4.2. Raporti i VNMS-së

Raporti bazë i VNMS-së përfshin aktivitetet e komunikimit dhe konsultimit në lidhje me Termat e Referencës, vlerësimin e opsioneve, përgatitjen e një analize të hendekëve në lidhje me kornizën kombëtare legjislative dhe rregullatore kundrejt standardeve të donatorëve dhe ndërkombëtare (siç përshkruhet në Kapitullin 2 të këtij dokumenti)[19] (si bazë për Raportin e VNMS-së). Këto aktivitete janë përshkruar në detaje në raportin e VNMS-së si dhe në tabelën 4 më lart.

[19] Kapitulli 2 - Kërkesat rregullatore për angazhimin e palëve të interesit

- **Letër zyrtare e dërguar më 19 gusht 2022 Sekretariatit të Këshillit Monitorues të Zbatimit** për Zonat e Veçanta të Mbrojtura, **Kosovë (për anëtarët statutore të KMZ-së, veçanërisht për kishën ortodokse serbe, si dhe përfaqësuesit e komunitetit mysliman, në lidhje me Zonën e Veçantë të Mbrojtur të Gazimestanit) duke ofruar një pasqyrë të projektit dhe gjurmës së projektit si dhe ftesa e përzemërt për KMZ-në që të krijojë një linjë komunikimi afatgjatë me TERMOKOS Sh.A.** ***(Kopjet e kësaj letre janë dhënë në Shtojcën 10.7)***

Procesi i raportimit të VNMS-së përfshin shpalosjen dhe konsultimin në lidhje me këtë raport, në përputhje me standardet dhe udhëzimet e institucioneve financuese dhe standardet lokale. Informacione të tjera relevante mjedisore dhe sociale do të vihen në dispozicion të publikut pas miratimit të draft raportit të VNMS-së.

5.4.2.1. Takime publike për përgatitjen e VNMS-së

Më 21 dhe 22 korrik 2022 janë mbajtur dy takime publike, përkatësisht më 21 korrik në Shkollën Dituria, Shkabaj, me 18 pjesëmarrës që përfaqësojnë zonat e Shkabajt, Hade e Re, Arbëria, dhe më 22 korrik në Shkollën Meto Bajraktari, me 9 pjesëmarrës nga Tophane/zonat e Prishtinës.

Këto takime publike u zhvilluan me banorët e interesuar në zonat e prekura dhe publikun e gjerë, dhe u udhëhoqën nga NP TERMOKOS Sh.A., dhe u mbështetën nga konsulentët e VNMS-së si pjesë e zhvillimit të Vlerësimit të Ndikimit Mjedisor dhe Social.

Sipas ftesës dhe agjendës së ndarë me pjesëmarrësit, u prezantuan dhe u diskutuan temat e mëposhtme:

- Informacione për Projektin Solar-Termal (Solar4Kosovo), zonat e prekura, përfitimet në terma të shkurtër dhe afatgjatë për banorët, karakteristikat kyçe të projektit (ndërsa raporti i studimit të fizibilitetit ishte ende në finalizim) - z. Naim Bytyqi, Termokos
- Procesi i Vlerësimit të Ndikimit Mjedisor dhe Social dhe konsideratat fillestare - z. Adrian Vaso dhe znj. Lumnije Gashi, (CES IS)
- Çështjet sociale, Plani i Rimëkëmbjes së Mjeteve të Jetesës dhe Plani për Angazhim dhe Komunikim të Palëve të Interesit - znj. Eldisa Zhebo dhe z. dhe Vigan Behluli (CES IS)
- Pyetje, komente dhe informacione nga publiku

Shënimet e hollësishme të këtyre takimeve, duke përfshirë shënimet për pyetje dhe përgjigje dhe sqarime për pjesëmarrësit, si dhe lista e pjesëmarrësve, fotot dhe dokumentet e tjera mbështetëse jepen në detaje në *Aneksin 10.6 - Takimet e konsultimit për VNMS/PAPI të 21-22 korrikut 2022)*

5.4.3. Studimi Bazë për Ndikimin Social - SBNS

Objektivi i studimit bazë të ndikimit social është identifikimi i ndikimeve të projektit në kushtet e jetesës së banorëve të zonës dhe klientëve komercialë (bizneseve). Studimi bazë ofron informacion empirik në lidhje me sfondin socio-ekonomik të përfituesve të projektit, si dhe atyre që do të përfitojnë me zbatimin e projektit dhe amvisërive që nuk do të kenë asnjë përfitim nga projekti (p.sh. grupi jo përfitues). Studimi bazë ofron të dhëna karakteristike socio-ekonomike nga amvisëritë përfituese dhe jo përfituese, duke përfshirë shpenzimet e energjisë dhe sjelljen e konsumit, si dhe opinionin, qëndrimin dhe përballueshmërinë e

përdorimit të ngrohtores së qytetit prej banorëve dhe bizneseve në kohën e anketimit (2022). Kjo mundëson krahasimin e rezultateve të anketës së vitit 2022 me anketa të ngjashme në të ardhmen pas zbatimit të projektit, si dhe mundëson studime socio-analitike mbi ndryshimet e opinionit/qëndrimit/ndërgjegjësimit ndaj furnizimit me NQ tek të anketuarit. Studimi bazë shërben gjithashtu për të vlerësuar paraprakisht ndikimet socio-ekonomike dhe mbi shëndetin dhe sigurinë në komunitet dhe për të hartuar një strategji/plan menaxhues të NJZP/TERMOKOS-it të identifikuar dhe njohur nga pjesëmarrësit e anketës pas zbatimit të projektit.

Për sa i përket komunikimit me palët e interesit - njoftimi zyrtar për publikun për fillimin e SBNS-së është bërë përmes ueb faqes së Termokos-it më 22 prill 2022.
Ueb faqja e Solar4Kosovo: https://TERMOKOS.org/category/solar-4-kosovo/
Facebook: https://www.facebook.com/NgrohtorjaTERMOKOS/.

Të njëjtat njoftime (broshura informative) janë shtypur dhe vendosur në ndërtesat e komunave të Prishtinës dhe Obiliqit, në shkollat në Shkabaj dhe Hade e Re, si dhe në disa vende brenda lagjes/lokacionit Hade e Re (Figura 5 më poshtë). Njoftimi përfshinte informacione kyçe në lidhje me qëllimin, rëndësinë, natyrën dhe kohëzgjatjen e anketës së publikuar me personat e prekur nga projekti (PPP) dhe popullatën e përgjithshme në zonën e studimit të projektit. Të gjitha materialet ishin të disponueshme në gjuhën angleze, shqipe dhe serbe.

https://termokos.org/2022/05/10/shperndahen-broshurat-informuese/
https://termokos.org/2022/04/22/njoftim-per-mbledhjen-e-te-dhenave-baze-socio-ekonomike/

Figura 5 - Kopja e njoftimit për fillimin e SBNS-së në gjuhën angleze (ana e pasme, ana e përparme)

INFORMACION

Solar4Kosovo II / Solar District Heating Kosovo

Our Investment

TERMOKOS Sh.A., the Municipal District Heating Company in Prishtina, Kosovo, is intending to invest in an environmentally friendly facility to produce 66 GWh/a additional heat energy capacity for the existing district heating network of Prishtina.

Through this investment, the district heating network can be extended and new customers will be connected, whereas all existing customers will profit from a more economic and more reliable heat supply.

The investment comprises the construction of a Solar Thermal Facility located on an unbuilt land plot near Shtime (Municipality of Obilic) of approx. 25 ha. The facility will be connected through underground pipelines with the existing District Heating network in Prishtina and with an existing transmission line in Obilic. The Project will be financed through loans and grants from the German Government provided through KfW Bank as well as co-financing from EBRD and an own contribution from TERMOKOS Sh.A.

Contact

More information about the project and submission of form can be found below

038 541 789

solar4kosovo@termokos.org
info@termokos.org

Termokos Sh.A
rr. 28 Nentori nr. 81
10000 Prishtinë
Republic of Kosovo

https://termokos.org/kategory/solar-i-kosoves/

TERMOKOS
ngrohtorja e qytetit

ANNOUNCMENT

FOR THE COLLECTION OF SOCIO-ECONOMIC BASELINE INFORMATION

Solar4Kosovo II / Solar District Heating Kosovo

Social Impact Assessment

In line with KfW's Sustainability Guidelines (2019) and other international standards, an Environmental and Social Impact Assessment (ESIA) is ongoing in order to identify and assess potentially negative and positive environmental and social risks and impacts of all phases of the proposed project, including its associated facilities.

As part of the social impact assessment process of the project, there is a need to collect socio-economic data from possible impacted households, businesses, communities, and public institutions. TERMOKOS Sh.A., supported by an international consulting organization – CES, IC consulenter (comprised of international and national experts), will conduct this process by visiting a sample of these households and businesses, conducting community visits, and collecting socio-economic information.

The collection of socio-economic information will be performed by social experts and trained surveyors, who shall be clearly identified that are part of this project. The collection of socio-economic data is intended to last between April and June 2022 and the collaboration of all visited households and communities is highly appreciated.

Should you have any comments or questions

The collection of socio-economic data (the studies and surveys) will inform the preparation of an Environmental and Social Impact Assessment (ESIA) and Livelihood Restoration Plan (LRP), which shall be prepared for the project in order to mitigate any potential negative impacts and enhance project benefits. TERMOKOS Sh.A. will ensure adequate implementation of project responsibilities and monitor activities foreseen in the ESIA and LRP.

You may reach out to TERMOKOS Sh.A. through the following means:

1. Filling out an inquiry form, as shown in Annex 1 at the end of this message; and

1.1. Handing over or submitting (by mail the request as in format provided in Annex 1 directly to **Termokos premises**.

1.2. Write an **email** with subject "Solar 4Kosovo" at, containing information that are described in Annex 1 inquiry form

2. Contact on the **phone**

3. Filling out a **form** with Subject "Solar4Kosovo" through the following link: **https://termokos.org/kontakt/**

Annex 1: Inquiry form

Fullname (optional): ___

☐ I wish to raise my question / concern anonymously

☐ I request not to disclose my identity without my consent

Contact information

Please mark how you wish to be contacted (mail, telephone, e-mail).

☐ By Post. Please provide mailing address: ___

☐ By telephone: ___

☐ By E-mail: ___

Preferred language of communication

☐ Albanian ☐ Serbian ☐ Other: ___

Description of information requested or concern:

What would you like to see happen?

Signature:

_____

Date:

_____

SBNS filloi më 5 maj 2022. Anketa u realizua përmes teknikës së Intervistës Personale të Asistuar me Kompjuter, përkatësisht mbledhjes së të dhënave përmes tabletave. Mbledhja sasiore e të dhënave përfundoi më 27 maj 2022. Janë kryer gjithsej 210 anketa, me 70 anketa për secilën shtresë të shpjeguar në tabelën 7 më poshtë: përdoruesit ekzistues, përdoruesit e mundshëm dhe jo përdoruesit (pjesë të tjera të qytetit që nuk janë planifikuar të lidhen për furnizim nga ngrohtorja e qytetit e Termokos-it).

Tabela 9 - Shtresat e llojeve të përfituesve të intervistuar për studimin bazë

Shtresa	Lloji i amvisërisë	Përshkrimi	Fusha e anketës	Fazat e ndikimit
1	Përfitues	Merr shërbim me sistem të ngrohtores së qytetit	Prishtina Jug	Faza e funksionimit
2	Përfituesi të mundshëm	Do te kyçen në sistemin e ngrohtores së qytetit	Prishtinë Tophane	Faza e funksionimit
3	Jo përfitues	Jo të kyçur në sistemin e ngrohtores së qytetit	Vetëm në Prishtinë	Faza e ndërtimit, faza e funksionimit

Kategoria e përdoruesve ekzistues është zhvilluar në 8 lagje të ndryshme të qytetit, përdoruesit e mundshëm në 4 lagje, ndërsa jo shfrytëzuesit në 6 lagje të qytetit të Prishtinës. Janë përpunuar të dhënat e mbledhura dhe janë prodhuar statistikat e përgjithshme (statistikat përshkruese) dhe rezultatet do të integrohen në një seksion të VNMS-së.

6 Burimet dhe përgjegjësitë për zbatimin e aktiviteteve për angazhimi të palëve të interesit

6.1. Përgjegjësitë e TERMOKOS-it

Një Njësi për Zbatimin e Projektit (NJZP) do të krijohet nga TERMOKOS-i, e cila do të jetë përgjegjëse për zbatimin e projektit dhe aktiviteteve dhe investimeve të nën-komponentit të veçantë. Komisioni i Projektit do të monitorojë zbatimin e aktiviteteve të planifikuara të angazhimit të palëve të interesit duke përfshirë zbatimin e aktiviteteve të planifikuara me këtë PAPI.

Ekipi i NJZP-së do të përbëhet të paktën nga një ekspert i Angazhimit të Palëve të Interesit (EAPI), i cili do të:

- promovojë projektin së bashku me komunat përfituese
- nxisë fushata ndërgjegjësuese
- ndërlidhet me komunat, komunitetet, grupet dhe palët e interesit
- zhvillojë konsultime publike dhe veprime angazhimi.

Veç kësaj, EAPI do të jetë përgjegjës për:

- administrimin e kanaleve të rrjeteve sociale të Projektit (p.sh. Ueb faqe, Facebook),
- bashkëpunimin me mediat lokale dhe eventet promovuese dhe reklamat.

EAPI do të jetë personi përgjegjës për zbatimin e PAPI-t gjatë gjithë ciklit të Projektit dhe i ngarkuar për të komunikuar me të gjitha palët e interesit.

Zbatimi i aktiviteteve të planifikuara në kuadër të këtij PAPI konsiderohet se do të mbulohet nga TERMOKOS-i.

6.1.1 Termat e Referencës për Ekspertin e Angazhimit të Palëve të Interesit të TERMOKOS-it/NJZP-së

Në kohën e këtij versioni të PAPI-i (gusht 2022), TERMOKOS-i nuk ka ende një Ekspert të dedikuar për Angazhimin e Palëve të Interesit (EAPI). Prandaj, këto TeR do të udhëheqin detyrat e përgjithshme për Ekspertin e Angazhimit të Palëve të Interesit (EAPI) që do të rekrutohet nga TERMOKOS-i për të gjithë ciklin e projektit dhe përfshijnë përgjegjësitë për mbikëqyrjen, koordinimin, zbatimin dhe monitorimin dhe raportimin e të gjitha aktiviteteve që lidhen me angazhimin e palëve të interesit në lidhje me këtë projekt, me aktivitetet e mëposhtme.

- Të zhvillojë, koordinojë dhe monitorojë të gjitha aktivitetet e angazhimit të palëve të interesit të përfshira në këtë Plan.
- Të përditësohet rregullisht PAPI në bashkëpunim me NJZP-në e TERMOKOS-it.
- Të përcaktojë burimet e nevojshme për zbatimin efektiv të PAPI-t
- Të jetë përgjegjës për zbatimin e aktiviteteve të angazhimit
- Të marrë pjesë dhe të udhëheqë takimet e palëve të interesit me anëtarët e ekipit teknik dhe
- Të sigurojë që reagimet dhe kërkesat e palëve të interesit drejtuar ekipeve teknike marrin përgjigje brenda afateve kohore të dakorduara
- Të përgatisë një draft komunikim dhe shpalosje të informacionit për palët e interesit, në veçanti për komunitetet, në një gjuhë të lehtë për t'u lexuar/kuptuar
- Të mbajë shënime për aktivitetet e angazhimit të palëve të interesit dhe komunikimet e ndërlidhura gjatë gjithë ciklit jetësor të Projektit
- Të regjistrojë kohën dhe përmbajtjen e informacionit për media
- Të mbajë një bazë të dhënash të të gjitha aktiviteteve të kryera për qëllime monitorimi, vlerësimi dhe raportimi, ku përfshihen:
  - Regjistri i palëve të interesit, i përditësuar periodikisht;
  - Regjistri i aktiviteteve për angazhim të palëve të interesit, me një tregues për çdo aktivitet të kryer, duke përfshirë vendndodhjen, pjesëmarrësit sipas kategorisë dhe numrit, informacionin e shpalosur dhe rezultatet e aktivitetit;
  - Regjistri i komenteve dhe përgjigjeve, i përditësuar gjatë gjithë ciklit jetësor të Projektit.
  - Versionet e mëparshme të PAPI-t.
  - Statusi i performancës së mekanizmit për ankesa.
  - Raportet periodike të përgatitura.

6.2. Palët e tjera përgjegjëse për zbatimin e PAPI-t

- Kontraktorët

Të gjithë kontraktorët përgjegjës për kryerjen e aktiviteteve të investimeve (nën-projekteve) specifike do t'u kërkohet gjithashtu të zbatojnë dispozitat përkatëse të PAPI-t në pjesë të veçanta që lidhen me punimet e

ndërtimit. Termokos-i do të mbikëqyrë dhe do të sigurojë që çdo Kontraktor i përgatit Marrëdhënie me Komunitetin dhe Informacionin me një procedurë të qartë për ndërveprim me palët e interesit dhe bën mbledhjen e reagimeve dhe sugjerimeve për çështjet që kanë të bëjnë me ndërtimin. Reagimet rreth aktiviteteve të ndërtimit, si rekomandimet e projektimit apo shqetësimet për qasjen, do të trajtohen sipas kësaj procedure dhe do të monitorohen nga Termokos-i. Përpara ndërtimit, publiku dhe komuniteti lokal do të informohen nga kontraktori i ndërtimit në nivel lokal.
Ndërtuesi është përgjegjës të përgatisë MSHS-në, Politikën e Burimeve Njerëzore dhe Mekanizmin për Ankesa të punëtorëve dhe të jetë në përputhje me këto kërkesa. Mekanizmi për ankesave për kërkesat e kontraktimit të punës do të përcaktohet në dokumentacionin e tenderit dhe kontratat e nënshkruara me kontraktorët

- Komunat e Prishtinës dhe Obiliqit

Janë përgjegjëse për të lehtësuar konsultimin publik dhe angazhimin me personat e prekur (pronarët dhe përdoruesit) në komunitetet në zonën e tyre dhe për shpalosjen e të gjitha dokumenteve relevante të PAPI-t

7 Mekanizmi për Ankesa

TERMOKOS-i ka themeluar NJZP-në për këtë projekt dhe do të zbatojë një procedurë për ankesa për projektin e përgjithshëm, duke përfshirë aktivitetet dhe investimet e nën-komponentit gjatë të gjitha fazave të projektit. NJZP-ja do të emërojë një person kontaktues përgjegjës për zbatimin e mekanizmit për ankesa. Të gjithë palët e interesit, në të gjitha aktivitetet do të informohen për ekzistimin dhe disponueshmërinë e mekanizmit për ankesave, kontaktet e personit të caktuar, si dhe format e parashtrimit të ankesave. Objektivi i procedurës së ankesave është të sigurojë që të gjitha komentet dhe ankesat nga çdo palë e interesit në projekt të merren parasysh dhe të adresohen në mënyrën e duhur dhe në kohë.

Palët e interesit do të informohen plotësisht për procedurat për ankesa në gjuhë të thjeshtë dhe në gjuhën e pakicave aty ku është e përshtatshme dhe sipas ligjeve të Kosovës. Të gjitha informacionet në lidhje me mekanizmin për ankesa dhe formularin për ankesa (Shtojca 1) do të vihen në dispozicion përmes informacionit online (ueb faqes së TERMOKOS-it) dhe në formë të shtypur në zonat publike të komunitetit, si dhe në ambientet e projektit dhe lokacionet e tjera që do të përcaktohen para fillimit të realizimit të aktiviteteve të projektit dhe/ose investimeve.

Të gjitha ankesat do të regjistrohen në Regjistrin e Ankesave të Projektit (Shtojca 3) dhe do të pranohen brenda 7 ditëve kalendarike. Pas pranimit të ankesës, personi përgjegjës i NJZP-së do ta informojë palën e interesit-ankuesin për hapat korrigjues të rekomanduar dhe çdo veprim pasues brenda 15 ditëve kalendarike, me e-mail ose si letër postare.

Personi i caktuar nga EAPI do të publikojë dhe përditësojë rregullisht të gjitha dokumentet relevante dhe procedurat për ankesa në ueb faqen e Projektit.
Në rast se TERMOKOS/ NJZP nuk është në gjendje t'i adresojë çështjet e ngritura me veprime të menjëhershme korrigjuese, do të identifikohet një veprim korrigjues afatgjatë, brenda 30 ditëve kalendarike pas pranimit të ankesës. TERMOKOS/ NJZP do të ofrojë një shpjegim/arsyetim të detajuar se pse çështja nuk

është adresuar dhe/ose nuk është në gjendje ta adresojë çështjen e caktuar të ngritur përmes mekanizmit për ankesa. Gjithashtu, në rast se nuk kërkohet ndonjë veprim, ankuesi do të marrë njoftimin. Përgjigja gjithashtu duhet të përmbajë një shpjegim se si mundet personi/organizata që ngriti ankesën të vazhdojë me ankesën në rast se rezultati nuk është i kënaqshëm. **Shih edhe Shtojcën 2.**

Në çdo kohë, ankuesit mund të kërkojnë mjete të tjera juridike në përputhje me kornizën ligjore të Kosovës, duke përfshirë ankesën zyrtare gjyqësore.

Një mekanizëm i veçantë për ankesa do të jetë i disponueshëm për punëtorët e brendshëm të NJZP-së, për çështjet që lidhen me PRMJ-në, si dhe për punët e kontraktuara/nënkontraktuara gjatë fazës së ndërtimit të projektit

Për momentin, të gjithë qytetarët duke përfshirë edhe palët e prekura në kuadër të këtij projekti mund të përdorin mënyrat e mëposhtme për parashtrim të ankesave ose që të kërkojnë më shumë informacion:

- Plotësimi i një formulari të kërkesës
- Dorëzimi ose dërgimi i kërkesës me postë në formatin e dhënë në Aneksin 1 direkt në **ambientet e TERMOKOS-it**.
- Shkruhet një **email** me temë: "Solar4Kosovo", që përmban informacione që janë përshkruar në Aneksin 1.
- Kontakt me **telefon**
- Plotësimi i **formularit** me temën "Solar4Kosovo" përmes linkut në vijim: https://TERMOKOS.org/kontakti/ - si në Figurën 6 më poshtë.

Figura 6 - Formulari i kontaktit të drejtpërdrejtë për pyetje në ueb faqen e TERMOKOS-it

Kontakt

Më shumë informata rreth projektit dhe dorëzimit të formularit mund të gjenden më poshtë



8 Monitorimi dhe Raportimi

Rezultatet e procesit të angazhimit të palëve të interesit do të përfshihen në raportet e monitorimit që do të përgatiten në mënyrë të brendshme nga TERMOKOS-i.

Raporti i parë do të përgatitet 3 muaj pas fillimit të Projektit dhe më pas do të përditësohet në baza tremujore.

Raportet do të publikohen në ueb faqen e TERMOKOS-it me informatat e mëposhtme:

- Vendi dhe koha e kryerjes së takimeve konsultative (duke përfshirë llojet e tjera të aktiviteteve të angazhimit) me informacion për pjesëmarrësit.
- Çështjet dhe shqetësimet e ngritura gjatë takimeve konsultative dhe informacionet se si janë marrë në konsideratë nga TERMOKOS çështjet e ngritura gjatë takimeve, duke përfshirë masat korrigjuese të zbatuara për adresimin e ankesave.
- Numri dhe llojet e ankesave të ngritura në raportimin e TERMOKOS-it, me tregues të ankesave të hapura, të zgjidhura dhe të mbyllura.

Veç kësaj, TERMOKOS-i do t'i dorëzojë KfW dhe BERZH Raportet Vjetore Mjedisore dhe Sociale duke përmbledhur ndikimet mjedisore dhe sociale, performancën e shëndetit dhe sigurisë, performancën e shpalosjes dhe konsultimit, si dhe zbatimin e mekanizmit të jashtëm për ankesa.

Njësia për Zbatim të Projektit e TERMOKOS-it do të jetë përgjegjëse për monitorimin e të gjitha aktiviteteve të angazhimit të palëve të interesit në lidhje me Projektin, duke siguruar përmbushjen dhe përditësimin e këtij PAPI dhe raportimin tek KfW dhe BERZH.

9 Detajet e kontaktit dhe përgjegjësitë për zbatimin

Personi përgjegjës për zbatimin e Planit për Angazhim të Palëve të Interesit është:

TERMOKOS Sh.A.
Rr. 28 Nëntori nr. 181,
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës
info@TERMOKOS.org
solar4kosova@TERMOKOS.org telefon: 038 541780

10 Aneks

10.1. Shtojca 1: Formulari për Ankesa i Projektit

Numri i referencës	
Emri i plotë (opsionale) Dua ta paraqes ankesën time në mënyrë anonime. Kërkoj të mos shpaloset identiteti im pa pëlqimin tim.	
Informata të kontaktit Ju lutemi shënoni se si dëshironi të kontaktoheni (postë, telefon, email).	Me Postë: *Ju lutemi shënoni adresën e postës:* Me telefon: Me email
Gjuha e preferuar e komunikimit	Shqip - Serbisht - Tjetër:

Përshkrimi i incidentit të ankesës	Çka ndodhi? Ku ndodhi? Kujt i ndodhi? Cili është rezultati i problemit?
Data e Incidentit / Ankesës	
	Incident/ankesë për një episod (data) Ka ndodhur më shumë se një herë (sa herë?) Në vazhdim (duke përjetuar problem)
Çka do të dëshironit të shihnit të ndodhte?	
Informacione të kontaktit për pyetje dhe shqetësime: Lënda: Solar4 Kosovo Në vëmendje të: TERMOKOS Sh.A. Rr. 28 Nëntori nr. 181, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës solar4kosova@TERMOKOS.org telefon:+383 38 541780	Nënshkrimi: Data:

10.2. Shtojca 2: Procedura për Ankesa e Projektit



10.3. Shtojca 3: Regjistri për Ankesa i Projektit

Data e pranimit	Emri i ankuesit	Kanali i komunikimit (si)	Komponenti dhe Investim	Përshkrimi i problemit	Veprimet e ndërmarra	Data e vendimit

10.4. Shtojca 4: Raport për Dokumentimin e Aktivitetit për Angazhim të Palëve të Interesit

Numri:	Data dhe vendi i takimit:
Qëllimi i angazhimit: (për shembull, për të informuar palët e interesit për një projekt të synuar ose për të mbledhur pikëpamjet e tyre për ndikimet e mundshme mjedisore dhe sociale të një projekti të synuar)	
Format e angazhimit dhe konsultimit: (për shembull, takime sy më sy si debatet ose punëtoritë, fokus grupet, konsultimet me shkrim, konsultimet online)	
Numri i pjesëmarrësve dhe kategoritë e pjesëmarrësve:	
Lista e dokumentacionit relevant që u shpaloset pjesëmarrësve:	
Përmbledhje e pikave kryesore dhe shqetësimeve të ngritura nga palët e interesit:	
Përmbledhje se si morën përgjigje dhe u morën parasysh shqetësimet e palëve të interesit:	
Çështje dhe aktivitete që kërkojnë veprime përcjellëse, duke përfshirë sqarimin si informohen për vendimet palët e interesit:	

10.5. Shtojca 5: Lista fillestare dhe informatat e kontaktit të OJQ-ve palë të interesit të identifikuara

OBILIQ

Iniciativa Qytetare për Mbrojtjen e Mjedisit në Obiliq IQMM
Ramadan Hashani
Obiliq, Rr. Hasan Prishtina p.n.
Tel. 044/361-089 (Mob)
Email: iqmm@hotmail.com

PRISHTINË

Ambienti e Demokracia (ADM).
Rr. Genci Nr. 27 Fushe Kosove
10000 Prishtinë, Kosovë
Tel: (044) 219-695
E-mail: adm_ja@yahoo.com
Udhëheqës: Magbule Krasniqi, Drejtoreshë
Personi kontaktues: Bajram Ferati

Iniciativa për Mbrojtjen e Mjedisit 'Natyra' (EPI Natyra)
Ulpianë D1/9/6, 10000 Prishtinë, Kosovë
Tel: (044) 192-795, (044) 206-254
E-mail: shjusufi@yahoo.com
Udhëheqës: Bardha Korga, drejtoreshë e përgjithshme

Instituti i Kosovës për Politika Zhvillimore (IKPZH)
Rr. Azem Bejta, Nr. 21, 10000 Prishtinë, Kosovë
Tel: (044) 151-115, (044) 502-546, (038) 239-010
E-mail: instituti_politik@yahoo.com
Udhëheqës: Blerim Burjani, udhëheqës

Shoqata e Ekologëve të Kosovës (SHEK)
Rr. 'Nëna Terezë' Fakulteti i Shkencave Matematike-Natyrore, Nr. 54, 10000 Prishtinë, Kosovë
Tel: (044) 129-671
E-mail: behxhetm@yahoo.com
Udhëheqës: Behxhet Mustafa, kryesues
Personi kontaktues: Avni Hajdari

Shoqata e Bujqësisë Organike e Kosovës (SHBOK)
Rr. Bill Clinton p.n., 10000 Prishtinë
Fakulteti i Bujqësisë, Prishtinë, Kosovë
Tel: (377-44) 175-277, (381-38) 540-846, (381-38) 540 668

E-mail: shbok_ad@hotmail.com
Ueb: www.shbok.org

Organizata për Hulumtime dhe Aktivitete Sociale dhe Mjedisore
Yllke Sadiku
Lagjja Pejton, Rr. "Johan V. Hahn", Prishtinë p.n.
Tel +386 49 643393 (Mob)
Email: osera.ngo@gmail.com

Organizata Joqeveritare për Mjedis dhe Biodiversitet - Miqtë e Natyrës
Dukagjin Zeka
Fushë Kosovë, Rr. Nena Terezë p.n.
Tel 044/114-913; 044/209-100
Email: miqtenatyres@yahoo.com

Klubi Kosovar për Energji dhe Mjedis KKEM
Arbëresha Meha
Prishtinë, Kodra e Diellit Zona Qendër, H-3 Nr. 6
Tel. +37744160907 (Mob)
Email: arbreshameha@gmail.com

Lëvizja Mjedisore e të Rinjve të Kosovës LMRK
Refet Citaku
Prishtinë, Fakulteti i Shkencave Matematiko-Natyrore
Tel. 044/ 414-703; 044/ 362-867 (Mob)
Email: rafeti1981@hotmail.com

Shoqata Dashamirët e Mjedisit DeM
Burim Zagragja
Prishtinë, Rr.Pashko Vasa Nr. 18
Tel. 038/248-740 (Tel) 044/118-610; 044/273-273 (Mob)
Email: dem@kujtesa.com

Qendra për Mjedis dhe Energji Alternative CE&AE
Visar Gashi
Prishtinë, Rr. Zenel Salihu, B. 14 - 23 - 1
Tel. 044 /678-464
Email: infoo.ceae@gmail.com

Instituti i Kosovës për Hulumtime të Ujit dhe Mjedisit KIWER
Ramiz Kokollari,
Prishtinë, Rr. Agim Ramadani Nr. 26
Tel. 044/159-456
Email: kkiwer@rocketmail.com

Aleanca për Mjedis dhe Energji AMEN
Arlind Gjikolli
Prishtinë, Fehmi Agani Nr. 35 2/2
Tel. 049/137-640
Email: info@amen-ks.com

Organizata për Mjedis dhe Shëndet OMSH
Muzafer Shkodra
Prishtinë, Rr. Agim Ramadani B1
Tel. 044/440-668 (Mob)
Email: muza_82@hotmail.com

Shoqata Mjedisore ProGEO Kosova
Prishtinë, Ulpianë D-3/3 Tel. +377 44 146861 (Mob)
Email: progeokosova@yahoo.com

Shoqata Humanitare Bamirëse dhe Mbrojtje të Mjedisit "Jeta 2009"
Shoqata Humanitare Bamirëse dhe Mbrojtje të Mjedisit "Jeta 2009"
Blerim Mehmeti
Prishtinë, Lagja Sofalia Lagja e re p.n.
Tel. 044/874-080 (Mob)
Email: mehmetiblerim@yahoo.com

ECO Mjedisi Prishtinë
Gjelal Zhuniqi
Prishtinë, Qamil Bala 2/H14, Bregu i Diellit, 10000 Prishtinë
Tel. +377 44 242976
Email: ecomjedisi@outlook.com

Qendra për Shkence dhe Mbrojtjen e Mjedisit CSEP
Rinor Berisha
Prishtinë, Vasil Andoni
Tel. +383 49 644163
Email: centerforsciencee@gmail.com

Iniciativa Kosovare për Mjedis dhe Bujqësi të Qëndrueshme KIESA
Labinot Kryeziu
Fushë Kosovë, Rr. Nëna Terezë Nr. 538/
Tel. +383 45 626707
Email: kiesa.rks@gmail.com

Organizata për Mjedis, Energji, Klimë dhe Agrokulturë OMEKA
Ilir Morina

Prishtinë, rruga Sefedin Vitija p.n. Çagllavicë
Tel. +383 44 504013
Email: ilirmo@yahoo.de

10.6. Takimet e konsultimit për VNMS/PAPI, 21-22 korrik 2022

Solar4Kosovo

Shënime nga takimet publike për përgatitjen e VNMS-së

Data: 21 korrik 2022 Vendi: Shkolla Dituria, Shkabaj

Pjesëmarrësit: Naim Bytyqi dhe Gazmend Selimi (Termokos), Eldisa Zhebo, Andrian Vaso, Lumnije Gashi dhe Vigan Behluli (CES IS)

Pjesëmarrësit: 18, që përfaqësonin zonat Shkabaj, Hade e Re, Arbëri

Përmbajtja

Shënime të përgjithshme 2
Përmbledhja e prezantimit 2
Shënime për pyetjet dhe sqarimet me pjesëmarrësit 6
Anekset 6
A.1 Foto nga eventi 6
A.2 Lista e pjesëmarrësve 8
A3. Njoftimi dhe agjenda 9
A.4- Prezantim në Power Point Presentation në shqip 10

Shënime të përgjithshme

U mbajt një takim publik me banorët e interesuar në zonat e prekura dhe publikun e gjerë, i drejtuar nga NP TERMOKOS Sh.A. si pjesë e zhvillimit të Vlerësimit të Ndikimit Mjedisor dhe Social (VNMS) më 21 korrik 2022, ndërmjet orës 18:00 - 20Ë00 në shkollën "Dituria" në fshatin Shkabaj.

Sipas ftesës dhe agjendës së ndarë me pjesëmarrësit, u prezantuan dhe u diskutuan temat e mëposhtme:

- Informacione për Projektin Solar-Termal (Solar4Kosovo), zonat e prekura, përfitimet në terma të shkurtër dhe afatgjatë për banorët, karakteristikat kyçe të projektit (ndërsa raporti i studimit të fizibilitetit ishte ende në finalizim) - z. Naim Bytyqi, Termokos
- Procesi i Vlerësimit të Ndikimit Mjedisor dhe Social dhe konsideratat fillestare - z. Andrian Vaso dhe znj. Lumnije Gashi, (CES IS)
- Çështjet sociale. Plani i Rimëkëmbjes së Mjeteve të Jetesës dhe Plani për Angazhim dhe Komunikim P Palëve të Interesit - znj. Eldisa Zhebo dhe z. Vigan Behluli (CES IS)
- Pyetje, komente dhe informacione nga publiku

Përmbledhje e prezantimit

Z. Naim Bytyqi bëri një pasqyrë të përgjithshme të projektit, duke informuar se Agjencia Ekzekutive e Projektit (AEP) dhe përfitues i drejtpërdrejtë është TERMOKOS Sh.A. - Kompania e Ujësjellësit Komunal të Prishtinës e cila mbështetet nga Komuna e Prishtinës edhe në çështjet administrative dhe politike. Financimi do të mbulohet nga Qeveria Gjermane përmes KfW, bashkëfinancuar nga BERZH, dhe do të bashkëfinancohet me kontributin e vet nga TERMOKOS Sh.A. Grantet shtesë pritet të zotohen nga Korniza e Investimeve të Ballkanit Perëndimor (WBIF) Gjatë viteve 2021/22 procesi i VNMS-së është mbështetur nga CES Clean Energy Solutions GesmbH (Vjenë, Austri), nënkontraktor (iC consulenten, AlpS) nëpërmjet Konsulentëve Kombëtarë dhe Ndërkombëtarë.
Solar 4 Kosovo synohet të jetë një impiant termik-solar miqësor ndaj mjedisit për të prodhuar 65 Gwh/një kapacitet shtesë i energjisë termike për rrjetin ekzistues të ngrohtores së qytetit të Prishtinës. Rrjeti i ngrohtores së qytetit do të zgjerohet dhe do të kyçen klientë të rinj, ndërsa të gjithë klientët ekzistues do të përfitojnë nga një furnizim më ekonomik dhe i besueshëm me ngrohje. Investimi përfshin ndërtimin e objektit në një parcelë të pazhvilluar afër Shkabajt (Komuna e Obiliqit) prej përafërsisht 25 ha. Objekti do të lidhet përmes tubacioneve nëntokësore me rrjetin ekzistues të ngrohtores së qytetit të Prishtinës dhe me linjën ekzistuese të transmisionit në Obiliq.
Vlerësim i Ndikimit Mjedisor dhe Social (VNMS) është në vazhdim për të identifikuar dhe vlerësuar risqet dhe ndikimet e mundshme negative dhe pozitive mjedisore dhe sociale të të gjitha fazave të projektit të propozuar, duke përfshirë objektet shoqëruese të tij.
Zhvillimet e tjera të projektit janë:

- Studimi i Fizibilitetit për rrjetin e ngrohtores solare të Kosovës
- PAPI - Plani për Angazhim të Palëve të Interesit - përpjekjet për angazhimin e palëve të interesit, të cilat përfshijnë identifikimin dhe angazhimin me palët e interesit që mund të ndikohen nga projekti në një mënyrë kuptimplote

Z. Andrian Vaso dhe znj. Lumnije Gashi, (CES IS) prezantuan procesin e Vlerësimit të Ndikimit Mjedisor dhe Social (VNMS) dhe konsideratat fillestare.

Qëllimi i VNMS-së është të identifikojë dhe vlerësojë risqet dhe ndikimet e mundshme negative dhe pozitive mjedisore dhe sociale, përgjatë të gjitha fazave të projektit të propozuar.

Rezultati do të jetë një raport me masat e propozuara zbutëse për të shmangur, minimizuar ose zbutur këto ndikime/risqe të mundshme duke u përpjekur për rritjen e përfitimeve për komunitetet lokale dhe mjedisin.

Produktet e planifikuara:

- Raporti i Vlerësimit të Ndikimit Mjedisor dhe Social (VNMS) së bashku me Planin e Rimëkëmbjes së Mjeteve të Jetesës (PRMJ)
- Plani për Menaxhim Mjedisor dhe Social (PMMS)
- Analiza e riskut klimatik
- Plani për Angazhim të Palëve të Interesit (PAPI)

Metodologjia përfshin një proces kompleks si p.sh

- Analiza e dokumenteve, strategjive, planeve hapësinore, kornizës ligjore, vendimeve të qeverisë etj.
- Studime mjedisore për gjendjen ekzistuese:
- Analizat fiziko-kimike të tokës, sedimentit, ujit
- Analiza për cilësinë e ajrit, për nivelin aktual të zhurmës dhe dridhjeve. Analiza për ekologjinë dhe biodiversitetin etj.
- Studimet sociale duke përfshirë çështjet socio-ekonomike, trafikun dhe transportin, trashëgiminë kulturore, gjetjet arkeologjike, peisazhin dhe aspektet vizuale
- Studimi i klimës dhe ndryshimeve klimatike, si historiku dhe prania e klimës, parashikimi i klimës IPCC, vlerësimi i riskut klimatik për fazën e funksionimit.
- Vizita në terren, dokumentacion përmes fotografisë dhe hartave GIS.
- Takime, intervista, konsultime me zyrtarë institucionalë/qeveritarë etj., si dhe takime. Intervista dhe konsultime me individë dhe përfaqësues të komunitetit.

Z. Vigan Behluli (CES IS) dha informacion në lidhje me Planin e Rimëkëmbjes së Mjeteve të Jetesës (PRMJ). Ai i informoi pjesëmarrësit se PRMJ është një dokument që vlerëson ndikimin e mundshëm social në amvisëri dhe komunitete dhe rekomandon masa për të adresuar ndikimet e identifikuara. Ndikim social nënkupton kur përdorimi i parcelave pengohet ose kufizohet përkohësisht ose përgjithmonë për qëllime të përdorimit për mirëqenie, si p.sh. nëpërmjet punimeve të ndërtimit. Dokumenti do të bazohet në procesin e Anketës së PRMJ-së bazuar në profilin socio-ekonomik të amvisërive dhe komuniteteve të prekura. Projekti konsideron se pronarët e parcelave të prekura kanë të drejtë të përfitojnë nga masat e parashikuara në kuadër të PRMJ-së. Prandaj, inkurajohen të gjithë palët e interesit të zonës së prekur të marrin pjesë në anketën socio-ekonomike, duke kontaktuar TERMOKOS-in përmes telefonit, në numrin 038 541 780, ose me e-mail, në adresën solar4kosova@TERMOKOS.org dhe të lënë detajet e kontaktit, ndërsa më pas do të kontaktohen nga anketuesit e angazhuar për anketën; ose Vizitoni shkollën Dituria/Meto Bajraktari, çdo ditë pune, nga data 25 korrik deri më 5 gusht, nga ora 16:00 deri në ora 18:00, ku anketuesit do të kryejnë anketën socio-ekonomike me pronarët e paraqitur.

Znj. Eldisa Zhebo (CES IS) informoi për Planin e Informimit dhe Angazhimit të Publikut dhe Palëve të Interesit (PAPI)

Objektivi është të përmirësohet dhe lehtësohet vendimmarrja në lidhje me projektin dhe të krijohen mundësi për përfshirjen aktive të të gjitha palëve të interesit në kohën e duhur dhe në mënyrë kuptimplotë, dhe të ofrohen mundësi për palët e interesit që të shprehin mendimet dhe shqetësimet e tyre që mund të ndikojnë në vendimet e projektit.

Ajo vuri në dukje se ky takim është zhvilluar për zbatimin e planifikuar të aktiviteteve për angazhim të palëve të interesit për të informuar procesin e VNMS-së për Solar4Kosovo II, në kohën e përgatitjes së VNMS-së. TERMOKOS-i synon t'i ofrojë publikut dhe të gjitha palëve të interesuara dhe të prekura të gjitha informacionet relevante dhe dokumentet dhe informacionet e nevojshme sapo të përgatiten:

- Përmbledhja Jo Teknike (PJT) e VNMS-së;
- Plani për Angazhim të Palëve të Interesit[PAPI) duke përfshirë Mekanizmin për Ankesa;
- Vlerësimi i Ndikimit Mjedisor dhe Social (draft dhe përfundimtar);
- Plani për Menaxhim Mjedisor dhe Social (PMMS)

Këto dokumente dhe informacione të tjera do të jenë të disponueshme në mënyrat e mëposhtme:

- Kopjet fizike të dokumenteve do të vihen në dispozicion për shikim gjatë orarit të punës në ambientet e TERMOKOS Sh.A. (Rr. 28 Nëntori 181, Prishtinë)
- Në ueb faqen e TERMOKOS-it (https://TERMOKOS.org).
- Ueb faqja zyrtare e projektit të TERMOKOS-it https://TERMOKOS.org/category/solar-4-kosovo/
